



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 7 Prill 2013

ISSN 2225-2959  
9 772225 295004



**SHKRIRJET & BLERJET**  
*A po vijnë?*



**ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS**  
**SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**

**aab-ankande.com**

Ankande dhe prona për shitje



**Kliko**

**dhe informohu!**



**AAB rrit transparencën dhe ofron informacion mbi ankandet dhe shitjen e pronave të paluajtshme - kolaterale të huave bankare.**

**ANËTARËT E AAB**


# Përmbajtja

## EDITORIAL

Shkrirjet & blerjet në sistemin  
bankar shqiptar... ante portas? *nga Elvin MEKA*

f.5

## TEMA E DITËS

Shkrirjet dhe blerjet në sistemin bankar shqiptar –  
a po duken në horizont? *nga Aydin ARGIN*

f.6

Bankingu në Shqipëri – A ka ardhur koha për shkrirje  
dhe përthithje (M&A)? *nga Arjan KADAREJA*

f.9

Ulja e normës bazë të interesit: OK por...  
*nga Ard KOLA*

f.11

## INTERVISTA

15 vitet shqiptare të Alpha Bank  
*Intervistë me Z. Periklis DROUGKAS*

f.13

## SISTEMI BANKAR

Paketa e re e ndryshimeve ligjore e rregullatore që lidhen  
me aktivitetin bankar – shumë të domosdoshme, por  
përtej masave... *nga AAB*

f.14

FATCA - Ligji "Për përputhshmërinë e pagimit të  
taksave për llogaritë e çelura në vendet e huaja"  
*nga Rozeta KOKALARI*

f.15

Shqipëria dhe Bazeli II: Sa afër jemi?  
*nga Ermira CURRI*

f.17

## FORUMI I EKSPERTËVE

Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile –  
mundësi për ekzekutime të detyrueshme më eficientë  
*nga Ejvis NDONI*

f.20

Prirjet e reja të bankikut qendror – modernizim apo  
sfidë? *nga Ela GOLEMI*

f.23

## KËNDI I EKONOMISTIT

Kriza financiare qipriote - bankat nën presionin e  
taksimit të depozitave *nga Adrian CIVICI*

f.25

## PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Aktivitete nga Bankat  
Ryder Albania

f.29

f.31

## NJË BANKIER NDRYSHE

## RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.33

## TEKNOLOGJI

Monitorimi në kohë reale kundër mashtrimeve, si masë  
revolucionarizuese për zbulimin e mashtrimeve  
*nga Francisco JARAMILLO*

f.37

## AUDITORI FINANCIAR

Angazhimet për huat *nga Junida TATAJ*

f.39

## AAB

Aktivitetet e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.42



BANKIERI është publikimi zyrtar  
i Shoqatës Shqiptare të Bankave  
i cili i dedikohet kryesisht sektorit  
bankar shqiptar. BANKIERI i  
jep lexuesit një informacion të  
vlefshëm mbi arritjet e industrisë  
në përgjithësi dhe të bankave  
tregtare në veçanti.

## Bankieri

Nr. 7, prill 2013

## Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

### Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshi)

Bashkëpunëtorë

Anduena Manushi

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Design & Layout: Ladybird Creations

Shtypi: Gent-grafik

### Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,  
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUÇIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm,  
NBG Bank Albania

Alexander RESCH

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &  
Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank

Hubert de SAINT JEAN

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &  
Drejtor i Përgjithshëm, Societe Generale Albania

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm  
Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm  
Alpha Bank Albania

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale  
Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

### SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

15 VJET  
PËRKUSHTIM  
NDAJ SECILIT PREJ  
**100.000**  
KLIENTËVE TANË



**NBG Bank**  
Tradicionalisht e besueshme

## SHKRIRJET & BLERJET NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR... ante portas?



nga Dr. Elvin MEKA<sup>1</sup>  
Kryeredaktor

Objektivat e qenësishme këtu mund të jetë pak joortodokse, pasi çështjet më aktuale mbizotëruese të sistemit janë zvogëlimi i rrezikut, vështirësia e krijimit të vlerës së shtuar dhe diferencimit të produkteve

Kjo nuk është një pyetje retorike, por më tepër është një pyetje me alternativa zgjedhjeje. Si një nga transaksionet më komplekse të botës së biznesit, është e qartë për bankat në Shqipëri se zgjedhja e tyre për t'u angazhuar në bashkime dhe blerje (M&A), do të bazohet në një analizë shumëdimensionale dhe tërësore. Sigurisht, kur është fjala për M&A-të çdokush mendon praktikisht se ky proces synon kryesisht uljen e kostove dhe krijimin e vlerës së shtuar, por kjo nuk është gjithçka. Siç theksohet dhe nga shoqëria McKinsey: *"... arsyetimi strategjik për një shkrirje & blerje që krijon vlerë të shtuar zakonisht përputhet me të paktën një nga pesë qëllimet bazë në vijim: përmirësimin e ecurisë së shoqërisë së synuar, zvogëlimi i kapaciteteve të tepërta në një industri e caktuar, krijimi i qasjeve në treg për produkte të caktuara, zotërimin më të shpejtë të aftësive ose teknologjive me një kosto më të ulët sesa zhvillimi i tyre me forcat e veta dhe tërheqja e elementëve fitues në fazat e hershme, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë bizneset e tyre."* Shihet pra se M&A-ja është një proces shumëplanësh, veçanërisht në kuadër të pasojave të krizës ekonomike dhe financiare të viteve 2008-2009. Gjithsesi, nuk është vetëm kriza ajo që i shtyn bizneset drejt angazhimeve për kryerjen e M&A-ve, pasi procese të tilla realizohen edhe në kulmin e zgjerimit dinamik të ekonomisë dhe ciklit të biznesit. Prandaj, kjo nuk lidhet shumë me çështjen e situatave të krizës apo begatisë, por është një çështje e logjikës së biznesit.

Peisazhi bankar shqiptar duket si një vend i pazakontë për realizimin e ndonjë shkrirje & blerje nga dhe brenda Shqipërisë, pasi bankat mëmë vijnë

nga vende të ndryshme dhe përfaqësojnë disa prej bankave ose grupeve bankare më përfaqësuese në vendet e tyre. Përvoja e shkurtër që sistemi bankar shqiptar ka krijuar në drejtim të M&A-ve, deri më tani, duket e suksesshme (lexoni më shumë në lidhje me këtë në faqen 6), por sistemi bankar është ende në pritje të një shkrirje & blerje "të pastër" shqiptare. Sigurisht, objektivat e qenësishme këtu mund të jetë pak joortodoksë, pasi çështjet më aktuale mbizotëruese të sistemit janë zvogëlimi i rrezikut (ose thënë ndryshe marrja e një rreziku besueshmërie më të madh, duke zgjeruar mekanikisht portofolin e huave), vështirësia e krijimit të vlerës së shtuar dhe diferencimit të produkteve.

M&A-ja e parë bankare "shqiptare", do të jetë një gur kilometrik për sistemin bankar, lidhur me objektivat përkatëse, efikasitetin e saj dhe zhvillimin e mëtejshëm të subjektit të ri. Por a mund të jetë i suksesshëm ky proces? Kjo është një pyetje një milion dollarësh, por ajo që mund të thuhet në këtë rast është nëse përfitimet e synuara tejkalojnë rreziqet që sipërmerren. Për fat të keq nuk ka ndonjë formulë magjike, që garanton suksesin e një shkrirje & blerje, pasi si çdo proces tjetër biznesi ato nuk mund të jenë në mënyrë endemike të mira apo të këqija.

Megjithatë, siç thoshte dikur dhe Sër Uinston Çërcill: *"Nuk mjafton të bëjmë më të mirën, por nganjëherë duhet të bëjmë atë që është e nevojshme!"*

<sup>1</sup> Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

## SHKRIRJET DHE BLERJET NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR – A PO DUKEN NË HORIZONT?



nga **Aydin ARGIN**

Drejtor i Grupit të Bankingut  
Tregtar dhe Korporatave  
Banka Kombëtare Tregtare, BKT

Çështja e shkrirjeve dhe blerjeve ka qenë shpesh e pranishme në mjedisin e biznesit ndërkombëtar, por arsyet që çojnë në një shkrirje, ndryshojnë nga njëra kohë në tjetrën, në varësi të mundësive që kërkohen të shfrytëzohen, apo nga reagimi ndaj ngjarjeve të caktuara. Ngjarja më e fundit, ndaj së cilës mund të reagohej është kriza financiare, kështu që përgjigja duhet të shihet nën këtë këndvështrim. Përgjithësisht, kur diskutohet rreth shkrirjeve dhe blerjeve duhet t'u përgjigjemi pyetjeve në vijim:

- A krijon vlerë të shtuar shkrirja në fjalë?
- A është e mirëargumentuar nga ana e drejtimtë të lartë shkrirja e propozuar?
- Cila shoqëri e përfiton rritjen e vlerës (nëse ka), që krijohet nga shkrirja?
- A do të ketë kundërshti e mbrojtje ndaj përthithjes, e nëse po, si do të ndikojnë masat mbrojtëse të shoqërisë së synuar, në suksesin e realizimit të shkrirjes?"

Shumë shoqëri i përdorin shkrirjet dhe blerjet, si një mënyrë për të

Në Shqipëri praktika e shkrirjeve dhe blerjeve ka qenë dinamike dhe është zbatuar me sukses gjatë 10 viteve të fundit, por nëse duhet gjykuar mbi perspektivën e shkrirjeve dhe blerjeve në këtë treg, duhet që fillimisht fenomenet të shqyrtohen nën një perspektivë më të gjerë.

siguruar rritjen, ndërkohë që të tjerat mund t'i përdorin ato për të diversifikuar bizneset e tyre. Në çdo rast, këto aktivitete mbeten temat më të diskutueshme në lëmin e financës dhe shoqërohen me çështje të ndërlikuara ligjore, tatimore dhe sinergjike. Shkrirjet dhe blerjet mund të kryhen në forma të ndryshme (miqësore apo jomiqësore), por thuhet gjithmonë dikush mbetet i pakënaqur (zakonisht menaxherët që largohen, apo punëtorët që pushohen nga puna).

Vitet nëntëdhjetë ishin dëshmitarë të krijimit të shoqërive lider të tregjeve kombëtare në Europë, ku shkrirjet ndërkufitare ishin të kufizuara. Në periudhën 2000-2008, shoqëritë u përqendruan në procesin e globalizimit dhe hapjen e tregjeve të reja, e kështu u angazhuan në shkrirje ndërkufitare, në shkallë të gjerë. Ky fenomen përfshiu të gjithë sektorët, por sektori financiar ishte skena e transaksioneve me peshë të madhe, e që kulmoi me krizën e huadhënies së viteve 2008-2009.

Gjithashtu, në qoftë se analizojmë në retrospektivë përvojën e sektorit bankar turk lidhur me shkrirjet dhe blerjet, kur ekonomia u godit nga dy kriza të rënda (nëntor 2000 dhe shkurt 2001), konsolidimi në sektorin bankar u ndihmua nga Qeveria,

d.m.th.: bankat në gjendje të vështirë financiare u shitën ose u bashkuan me banka/institucione të tjera, duke e çuar numrin e bankave, në vitin 2007, nga 68 në 50. Një tjetër tipar i rëndësishëm i kësaj vale shkrirjesh dhe blerjesh ishte angazhimi i madh i institucioneve të huaja në to, ku pjesëmarrja e huaj në aktivet e sektorit bankar u rrit në 22.7 për qind në shtator 2007, nga 4.3 për qind në vitin 2004 (CBT: Raporti i Stabilitetit Financiar, 2007).

Në Shqipëri praktika e shkrirjeve dhe blerjeve ka qenë dinamike dhe është zbatuar me sukses gjatë 10 viteve të fundit, siç mund të përmendet: shkrirja e Bankës Amerikane të Shqipërisë dhe Bankës Italo-Shqiptare, e kryer nga Intesa San Paolo Bank; blerja e Emporiki Bank nga Credit Agricole Group dhe blerja e Bankës Popullore (nga Societe Generale). Nëse duhet të gjykojmë mbi perspektivën e shkrirjeve dhe blerjeve në tregun shqiptar, duhet që fillimisht t'i shqyrtojmë fenomenet nën një perspektivë më të gjerë. Nëse i referohemi të dhënave të ofruara nga Instituti për Shkrirjet, Blerjet dhe Aleancat (IMAA)<sup>1</sup>, për sa i përket transaksioneve në Europë për vitin 2012, ato shënuan një rënie me 20 për qind në vit. Në aspektin e vlerës, sektori i shërbimeve financi-

Lidhur me sektorin bankar shqiptar, duke pasur parasysh zhvillimet e qenësishme në treg, shkrirjet dhe blerjet mund të mishërohen më shumë në formën e shkrirjes (bashkimit), si një përgjigje ndaj krizës ndërkombëtare, e për rrjedhojë, mund të marrin forma të caktuara, që janë tipike për fazat e stabilizimit ose të maturimit të biznesit, fazë në të cilën është industria bankare.

are zuri rreth 42 për qind të të gjitha marrëveshjeve, dhe 38 për qind të marrëveshjeve të regjistruara. Të dhënat janë vetëshpjeguese, të pak-tën në lidhje me dinamikën e tregut europian. Disa nga marrëveshjet më të mëdha europiane u ndikuan nga kriza e Eurozonës dhe procesi i shpëtimit nga falimentimi i bankave europiane, veçanërisht në Spanjë.

Zbatimi i një prirjeje të tillë në sektorin bankar shqiptar, duke pasur parasysh, gjithashtu, zhvillimet e qenësishme në treg, mund të mishërohet më shumë në formën e shkrirjes (bashkimit), si një përgjigje ndaj krizës ndërkombëtare, e për rrjedhojë, mund të marrë forma të caktuara, që janë tipike për fazat e stabilizimit ose të maturimit të biznesit, fazë në të cilën është industria bankare. Nëse i hidhet një vështrim sektorit bankar në Shqipëri, vërehet se disa nga lojtarët po paraqesin një prirje rënëse të aktiveve të tyre, për shkak të përjetimit të humbjeve të njëpasnjëshme. Gjykoj se kjo është një shenjë që tregon për hapësira për shkrirje

dhe blerje, pasi tregu po ngopet dhe shumë lojtarë nuk mund të veprojnë në mënyrë eficiente. Ky proces besoj se do të vijë më natyrshëm, sidomos nëse shkrirja do të ndodhë midis bankave nga i njëjti vend i origjinës, pasi sfidat me të cilat përballen janë shumë të ngjashme nga perspektiva në nivel të shoqërisë mëmë, si dhe njohuritë e lojtarëve të përfshirë në këtë proces janë më të konsoliduara. Përsëri, duke u bazuar në përvojën e sistemit bankar turk gjatë viteve 1999-2000, ky do të ishte një proces normal i konsolidimit të industrisë bankare. Problemi kryesor këtu është bilanci i përfitimeve, që do të mund të nxirrte cilido blerës nga ky transaksion, e kjo është një temë tejet e ndërlikuar për t'u trajtuar në disa rreshta.


Në një kuadër më të gjerë, arsyet që qëndrojnë pas shkrirjeve mund të jenë dhe sinergjitë që vijnë nga rritja, në vend të zhvillimit të brendshëm. Në fazën e stabilizimit, konkurrenca eliminon pjesën dërrmuese të potencialit të rritjes së industrisë, e kështu shkalla e rritjes është në përputhje me atë të ekonomisë në përgjithësi. Në këtë fazë, shoqëritë kërkojnë të shkrihen, për të krijuar ekonomitë e shkallës, me qëllim që të konkurrojnë me një strukturë kostoje më të ulët. Gjithashtu, ato mund të blejnë dhe shoqëri më të vogla, që mund të ofrojnë menaxhimin më të fortë dhe bazë më të gjerë financiare. Në këtë fazë, më të zakonshmet janë shkrir-

jet horizontale, ku shoqëritë më të forta blejnë ato më të dobëta, për të konsoliduar pjesën e tregut dhe për të zvogëluar kostot. BKT-ja është në këtë kategori, si një bankë që ka arritur nivele të kënaqshme të një rritjeje të qëndrueshme, si dhe ka fituar vazhdimisht pozicione të larta, në lidhje me bankat e krahasueshme me të.

Sa e lehtë mund të jetë kjo? Lehtësia dhe procesi i shkrirjes dhe blerjes janë dy terma që nuk shkojnë me njëra-tjetrën. Ajo kalon në një proces të gjatë dhe të ndërlikuar vlerësimi dhe realizohet përmes dy mjeteve të pagesës: oferta të holla (cash) dhe të ofertës me aksione.

Sipas ligjit shqiptar të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Konkurrencës, si agjenci rregullatore për shkrirjet dhe blerjet, mbikëqyr procesin pas miratimit paraprak të shkrirjes. Gjatë procesit të miratimit paraprak dhe zbatimit në praktikë të shkrirjes, merren në konsideratë disa kriteret të caktuara, të tilla si: raportet e përqendrimit, IHH (Indeksi Herfindahl Hirschman), në mënyrë që të sigurohet mungesa e pozicioneve monopol.

Ai duhet të jetë një proces i kujdesshëm dhe shumë profesional, ku konfidencialiteti dhe ruajtja e informacionit është thelbësor, për të shmangur keqpërdorimin e informacionit, luhatjen e çmimeve të aksioneve, apo ndonjë efekt tjetër të padëshiruar.



<sup>1</sup> Institute of Mergers, Acquisitions and Alliances.



**DËSHIRON TË BËSH NJË NDRYSHIM?  
BËHU PJESË E BANKINGUT TË PËRGJEGJSHËM  
APLIKO NË PROGRAMIN BANKIERËT E RINJ**



# BANKINGU NË SHQIPËRI – A KA ARDHUR KOHA PËR SHKRIRJE DHE PËRTHITHJE (M&A)<sup>1</sup>?



nga Arjan KADAREJA PhD  
Pedagog, UET

Spektori bankar është dhe mbetet pjesë më e rëndësishme e thelbësore e të gjithë sistemit financiar, për sa i përket mbështetjes dhe kontributit në rritjen ekonomike si dhe në formësimin e vetë këtij sistemi, dje, sot dhe të ardhmen. Gjatë 20 viteve të fundit, që përkon me periudhën e tranzicionit, sistemi financiar shqiptar ka sjellë në dritë dhe ka zhvilluar institucione dhe instrumente financiare deri dhe të panjohura më parë, të cilët janë ngushtësisht të lidhur me evolucionin e vetë sistemit bankar dhe institucioneve të tij. Sistemi bankar privat në Shqipëri ishte relativisht i ri. Ai ishte krijuar pothuajse më shumë se një dekadë më parë nëpërmjet licencimit të degëve dhe filialeve të bankave të huaja, privatizimit të bankave të vjetra shtetërore dhe blerjes së bankave të reja nga të huajt. Aktorët kryesorë në privatizim dhe në blerje ishin grupe bankare europiane të mirënjohura.


Kriza ekonomike e financiare globale dhe ndikimi i saj në veprimtarinë e përgjithshme të sistemit ban-

Procesi i shkrirjeve dhe përthithjeve (M&A-ve) mund të sjellë përfitime të rëndësishme për sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë shqiptare, në terma të efektivitetit, diversifikimit dhe zgjerimit të huadhënies.

kar shqiptar, si dhe problematikat që mund të vërehen brenda tij, do të ndikojnë në kursin dhe qasjen e re institucionale që do të ndjekë ai, në kushtet kur ky sistem po hyn në një fazë të maturimit të veprimtarisë së tij, duke u përballur dhe me një konkurrencë gjithnjë e më komplekse, brenda vetë sistemit financiar. Tani për tani sistemi bankar shqiptar shfaq tipare të një bankingu tradicional, d.m.th., jep hua për sektorin privat dhe blen borxh publik, kryesisht nëpërmjet financimit me anë të depozitave të klientëve. Duke marrë parasysh përvojën e mëparshme të bankave në Bashkimin Europian, në vijim mund të identifikohen shkrirjet dhe përthithjet (M&A) si një zhvillim i mundshëm i ardhshëm, brenda sistemit bankar shqiptar.

## SHKRIRJET DHE PËRTHITHJET (M&A) SI MUNDËSI NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Ekziston një literaturë e bollshme që trajton çështjen e M&A-ve në tregjet e reja. Fritsch et al. (2006) përcakton faktorët e suksesit që lidhen me transaksionet e M&A-ve, duke u përqendruar në tiparet e tregjeve të reja. Ata përcaktojnë se janë pikërisht faktorët që lidhen me tiparet e vendit dhe transaksionet specifike, ato që shpjegojnë rritjen e të ardhurave për bankat aksionare që propozojnë M&A-të. Vennet R Vander (2002) pohon se si banka blerëse ashtu dhe ajo e blerë paraqesin një dallim të dukshëm nga pikëpamja ekonomike para dhe pas procesit të M&A-së, si në terma të koston, ashtu dhe të efikasitetit të fitimit. Megjithatë, studimi zbulon se rezultatet konfirmojnë një zgjerim



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave

<sup>1</sup> Ky artikull është shkëputur nga punimi shkencor: "Bankingu në Shqipëri dhe rrugëtimi drejt së ardhmes", nga Dr. Elvin Meka dhe Arjan Kadareja PhD, paraqitur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: "Corporate Albania – The Past, the Present and the Future", UET, nëntor 2012.

të peshëm të efijencës së fitimit, por jo ndonjë përfitim të rëndësishëm, lidhur me efijencën e kostos. Sousa F (2004) përcakton se IHD-të nga ana e bankave mund të shpjegohen nga faktorë të tillë si: mundësitë nga kuadri rregullator, largësia dhe lidhjet socio-kulturore, kostot e ulta të informacionit, lidhjet e ngushta tregtare dhe afërsia gjeografike. Liao dhe Williams (2006) kanë gjetur evidenca që nuk mbështesin sugjerimet për një transferim të pasurisë nga aksionarët në tregjet e reja, në drejtim të palëve respektive në tregjet e industrializuara.

Në Shqipëri, procesi i M&A-ve dominohet nga blerjet ndërkufitare, që shfrytëzon kryesisht tregjet e brendshme të kapitalit (hua të lira në banka mëmë) si dhe deri diku dhe ekonominë e shkallës dhe produk-


Procesi i M&A-ve kombëtare (si transaksione të brendshme) nëpërmjet rritjes së portofoleve të bankave do të krijojë më shumë vend dhe hapësirë për marrjen e rreziqeve të investimit; kjo mund të rrisë madhësinë e portofolit të huadhënies.



tit (praktikat e mira të biznesit dhe teknikat nga mëma). Mendohet se tashmë mund të ketë ardhur koha për të ndërmarrë një proces M&A-sh në shkallë kombëtare (si transaksione të brendshme) brenda sistemit bankar shqiptar, me qëllim që bankat të mund të operojnë me një mbulim (shkallë) të plotë kombëtare e kështu të shfrytëzojnë ekonominë e shkallës (shihni figurën 1), duke sipërmarrë më shumë rrezik në portofolet e tyre të investimit. Në mbështetje të këtij argumenti, në figurën 2 paraqitet pjesa që zënë në PBB, raportin e huave sipas sektorëve ndaj totalit të huave dhe huatë sektoriale me probleme ndaj totalit të huave, për tre sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare: bujqësinë, ndërtimin dhe industrinë përpunuese. Kështu, edhe pse pjesa e bujqësisë në PBB, thuajse në nivele të barabarta me shumën e dy sektorëve të tjerëve, në raport me totalin e huave ajo përfaqëson vetëm një të dhjetën e huasë për

sektorin e ndërtimit, ose 1/7 e huasë për industrinë. Arsyeja paraqitet nga histogramat e mesit, ku përqindja e huave me probleme të sektorit të bujqësisë ndaj totalit të huave dominon qartësisht ndaj të dy sektorëve të tjerë. Qartësisht konkludohet se, procesi i M&A-ve kombëtare (si transaksione të brendshme) nëpërmjet rritjes së portofoleve të bankave do të krijojë më shumë vend dhe hapësirë për marrjen e rreziqeve të investimit. Kjo mund të rrisë madhësinë e portofolit të huadhënies. Megjithatë, M&A-ja nuk mund të jetë një zëvendësues për reformat shumë të nevojshme strukturore të tregut si psh: ato të lidhura me të drejtat e pronësisë, ekzekutimin e kolateralit, të drejtat ligjore të huadhënësve, etj. Dikush me të drejtë mund të ngrejë çështjen e zbehjes së konkurrencës, që shkaktohet nga procesi i M&A-ve, që rezulton në një numër më të vogël bankash të mëdha. Kjo është legjitime dhe e drejtë. Megjithatë, një numër i madh bankash nuk do të thotë detyrimisht konkurrencë më e fortë, ose një konkurrencë më e dobët nuk lidhet domosdoshmërisht me një numër të vogël bankash.

Në përfundim mund të thuhet se pas një dhjetëvjeçari të sistemit bankar shqiptar, ky i fundit ia ka dalë të mos preket ndjeshëm nga kriza globale si dhe të mund të realizojë nivele njëjtë të mira të aktiveve, depozitave dhe huave, duke i dhënë kështu një shtytje dhe mbështetje të madhe zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Gjithsesi, nëse do të mund të merret parasysh procesi i shkrirjeve dhe përthithjeve (M&A-ve), ai mund të sjellë përfitime të rëndësishme për sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë shqiptare, në terma të efektivitetit, diversifikimit dhe zgjerimit të huadhënies.



## ULJA E NORMËS BAZË TË INTERESIT: OK por...

Biznesit nuk i intereson shumë se si bankat përcaktojnë interesat e huave, pasi në finale i intereson të marrë financim për projektin, ndërsa bankat janë të gatshme të japin hua, por me kushte që nuk lidhen drejtpërdrejt me normën bazë të interesit.

nga Ard KOLA

Raporti mes bankave dhe pjesës tjetër të sipërmarrjes private ka hyrë në spirale që kërkon kujdes. Edhe pse të ndarë në pikëpamje, në thelb të dyja kampet, nëse mund t'i cilësojmë kështu, kanë të njëjtin synim: fitimin.

Banka e Shqipërisë po bën punën që i takon, deri në atë masë sa mundet. Uli për herën e gjashtë normën bazë të interesit, e cila aktualisht është 3.75%, nga 5.25% që ishte në shtator të vitit 2011. Natyrisht, nga BSH mund të pritët më shumë, të paktën sa i takon fleksibilitetit në organizimin e punëve, po të kihet parasysh procesi i stërzgatur i diskutimeve për ndryshimet ligjore në Kode (Civil dhe Procedurës Civile), që pas më shumë se një viti u miratuan nga Këshilli i Ministrave. Megjithatë, më mirë vonë se kurrë. Pritshmëria e rezultateve nga ndryshimet ligjore është optimiste. Fillimi i vitit 2013, ose tremujori i parë, shënoi dy ngjarje në tregun bankar. E para për uljen e mëtejshme të normës së interesit në Lek dhe e dyta, miratimi në Qeveri i ndryshimeve për Kodin Civil. Por a mjaftojnë këto për të zhbllkuar huadhënien për ekonominë? Ndërmjet këtyre dy zhvillimeve të rëndësishme përfaqësues të bankave dhe biznesit diskutuan për më shumë se 4 orë problematikën e kreditimit. Shigjetat ndaj njëri-tjetrit nuk munguan, edhe pse në thelb të dyja palët shprehnin të njëjtën gjë, por në forma të ndryshme.

Bankat nuk e kanë problem huad-

hënien, pasi para në formë depozitash ka boll. Mbetet për t'u diskutuar nëse duhet të jepen në Euro apo në Lek, por e rëndësishmja është që sistemi financiar është i qëndrueshëm. Nga ana tjetër, biznesi ka nevojë për financime dhe është i gatshëm të investojë. Pra, deri këtu duket se palët janë dakord. Po kush i ndan në pikëpamje bankat dhe biznesin? Deri në fund të dhjetorit, huat e akorduara arritën 577,8 miliardë lekë, me rritje vjetore 2%, ku kreditimi i biznesit pati rritje me 2.6%. Sot bankat kritikohen për

Bankat po i afrohen 10 miliard US\$ të depozitave dhe kanë shprehur interes të japin hua për projekte eficiente, bazuar në plane të shëndosha biznesi. Kjo është njëra anë, pasi më parë, biznesi duhet të likuidojë faturat e prapambetura ndaj bankave (huaja me probleme arrin mbi 22.5% e totalit të huave).

dorën e shtrënguar të financimit, njëlloj si 5-6 vjet më parë, kur huadhënia ishte më e lehtë dhe rritja vjetore arrinte në 50-60%. Ulja e normës bazë teorikisht duhet të japë efektet në uljen e kostos së transaksionit, dhe në fakt mes bankave, reflektimi ka ndodhur, por reagimi pritët te huaja. Duke parë historikun reagimi i bankave ndaj veprimeve të BSH-së për normën e interesit ka qenë i ngadaltë, d.m.th. ka ardhur pas 6-7 muajsh. Pavarësisht stimullit nga banka qendrore, "lojën" duket se e mban tregu i bonove të thesarit, mbi interesat e të cilit (bonove të thesarit 12-mujore) bazohen bankat për përcaktimin e interesit të huave. Fatmirësisht interesat e bonove të thesarit me afat 1-vjeçar kanë pësuar ulje, nga 7.37% në qershor 2012 (kur norma bazë ishte 4.25%), në 6.3% (kur norma ra në 4%) në dhjetor. Në janar 2013 interesat e bonove të thesarit u rritën dhe natyrshëm, për shkak të nevojës së Qeverisë për parë, megjithatë prirja është drejt rënies, duke patur parasysh se në janar norma bazë zbriti në 3.75%. Megjithatë, këto janë strategji të bankave, që në fund të fundit biznesit nuk i interesojnë shumë, pasi në finale i intereson të marrë financim për projektin, ndërsa bankat janë të gatshme të japin hua, por me kushte që nuk lidhet drejtpërdrejt me faktorët e mësipërm. Kështu, të dyja palët duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën, për të arritur qëllimin e përbashkët dhe që viti 2013 të jetë ndryshe nga të tjerët.

**E-Commerce**



## Pranoni blerjet në internet me shërbimin **E-Commerce**

- Shisni produktet dhe shërbimet nga faqja juaj e Internetit shpejt dhe thjeshtë
- Pranoni pagesa me karta Visa dhe MasterCard të lëshuara nga çdo bankë në botë
- Ofroni sigurinë më të lartë me anë të teknologjisë 3D

[www.raiffeisen.al](http://www.raiffeisen.al)



**Raiffeisen  
BANK**

# 15 VITET SHQIPTARE TË ALPHA BANK



**Z. Periklis DROUGKAS**  
Drejtor i Përgjithshëm,  
Alpha Bank Albania

**BANKIERI:** ALPHA BANK SAPO KA FESTUAR PËRVJETORIN E PESËMBËDHJETË TË SAJ NË SHQIPËRI. SI MUND TA PËRMBLIDHNI ME PAK FJALË NJË EKSPERIENCË TË TILLË?

Siç e dini, Alpha Bank filloi të operojë në janar të vitit 1998, si degë e Alpha Bank AE. Grupi Alpha Bank është një nga grupet më të mëdha bankare në Greqi, i themeluar në fillim të vitit 1879. Përveç Greqisë, banka është e pranishme në Europën Juglindore, Britaninë e Madhe dhe në Qipro. Tashmë ndihemi të lumtur që festuam 15-vjetorin në, si filial e jo si degë. Gjatë gjithë këtyre viteve, kemi pasur kënaqësinë të kontribuonim në zhvillimin e vendit, duke financuar jo vetëm shoqëritë kryesore shqiptare, por dhe disa nga projektet më të mëdha infrastrukturore, si: "Rruga e Arbrit", Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, industrinë e telekomunikacionit etj. Alpha Bank ka qenë banka e parë që ka realizuar dhënien e huasë më të madhe ndaj shtetit shqiptar, me synim përfundimin e projekteve në rrugën e zhvillimit të vendit dhe integritimit në BE. Gjatë kësaj periudhe, ne u rritëm bashkë me klientët tanë dhe unë jam krenar të shprehem, se jemi aktualisht në gjendje të përmbushim jo vetëm nevojat, por dhe pritshmëritë e tyre, me shumë produkte dhe shërbime të ndryshme. Nuk mund të them se rruga drejt realizimit të tyre ka qenë e lehtë, përkundrazi jemi përballur me shumë sfida, por kemi arritur t'i kapërcejmë ato dhe jemi të gatshëm t'i shërbejmë tregut shqiptar, komunitetit të biznesit dhe individëve.

**BANKIERI:** SI NJË NGA LOJTARËT KYÇ TË INDUSTRIJË BANCARE SHQIPTARE, CILAT MENDONI SE JANË TIPARET THELBËSORE QË E BËJNË ALPHA BANK NJË BANKË TË RESPEKTUESHME DHE UNIKE NË VEND?

Kur flasim për pozicionin në treg, tradicionalisht Alpha Bank është perceptuar si bankë me një identitet të fortë huadhënës ndaj korporatave, bankë konkurruese dhe e orientuar drejt klientit. Ajo është perceptuar si një bankë e aftë për financimin e projekteve të mëdha, që kanë pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit. Transparenca, besueshmëria dhe përgjegjësia janë parimet që Alpha Bank Group ka ndjekur gjatë 130 viteve të fundit.

Banka do të vazhdojë të konsolidojë pozicionin në treg, të rrisë të gjithë aktivitetin e saj, si dhe të akomodojë të gjitha segmentet e konsumatorëve me produkte sipas kërkesave të tyre, duke ofruar dhe zgjidhje masive.

Tradita, stafi i mirëarsimuar, i ndihmuar dhe nga një përvojë ndërkombëtare, kanë rezultuar të jenë një kombinim fitues për bankën.

Vlen të theksohet se, në Alpha Bank një ekip i specializuar punonjësish angazhohet në krijimin e produkteve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, me qëllim që të plotësohen nevojat e klientëve dhe atyre t'u ofrohen produktet e duhura, apo për të cilat kanë realisht nevojë. Këtu mund të përmenden rreth 15 produkte të ndryshme depozitash, të cilat ofrojnë për klientët individualë norma kthimi fitimprurëse dhe fleksibilitet për në përdorimin e tyre, sipas preferencave përkatëse. Produktet e huadhënies për individë ofrojnë kushte e afate konkurruese, të tilla si: kohëzgjatje të favorshme dhe pagesat mujore të ulëta. Kartat e kreditit të ofruara nga Alpha Bank janë të markave American Express dhe VISA dhe u sigurojë klientëve tanë një sërë privilegjesh dhe përfitimesh. Përmbledhtazi, lidhur me produktet për individët, mund të them se ato përbëjnë risi dhe banka ofron për klientët shumë më tepër sesa përfitimet e sipërpërmendura. Praktikisht, mund të përmenden sigurimi i shëndetit, që ofrohet së bashku me llogaritë e kursimit, ose projektimi falas i mjediseve të brendshme të shtëpive dhe sigurim të pronës së blerë me hua, apo shumë zbritje për klientët tanë të kartave, në rrjetin e madh të tregtarëve. Ajo çka na dallon ne nga të tjerët, është vëmendja e veçantë që i kushtojmë nevojave të klientit dhe përqendrimi në gjetjen e zgjidhjen së duhur financiare për këto nevoja. Ne synojmë ta realizojmë këtë me eficiencë të lartë, krijimtari dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm.

**BANKIERI:** SI E MENDONI POZICIONIN DHE ROLIN NË TË ARDHMEN TË ALPHA BANK, BRENDA SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR?

Më 17 maj 2012, Alpha Bank Albania u transformua në degë të Alpha Bank A.E., me një kapital aksionar prej më shumë se 78 milionë Euro. Ky transformim ishte një proces në përgjigje të rritjes së besimit publik, dhe si një veprim për të parandaluar efektet negative të krizës së Eurozonës. Sigurisht, ne do të vazhdojmë të konsolidojmë pozitën tonë në treg, të rrisim të gjithë aktivitetin tonë, si dhe të akomodojmë të gjitha segmentet e konsumatorëve me produkte sipas kërkesave të tyre, por duke ofruar dhe zgjidhje masive. Infrastruktura jonë, kapitali njerëzor, kapacitetet dhe shpirti i suksesit janë pika kyçe dhe do t'i mundësojnë Alpha Bank të ruajë pozicionin e saj udhëheqës, mes institucioneve financiare në Shqipëri.

Në këtë vit të 15-të veprimtarisë tona në Shqipëri, ne festojmë si pjesë e realitetit shqiptar dhe po ndihmojmë që ky realitet të jetë më mirë për njerëzit në këtë vend, që e meritojnë shumë cilësinë gjithnjë në rritje të standardeve të jetesës dhe të punës.

## PAKETA E RE E NDRYSHIMEVE LIGJORE E RREGULLATORE QË LIDHEN ME AKTIVITETIN BANKAR – shumë të domosdoshme, por përtej masave...

**S**hoqata Shqiptare e Bankave (AAB), informon publikun lidhur me qëndrimin dhe opinionet e saj, rreth masave të marra dhe propozimet e pranuarra së fundmi në lidhje me rritjen e huadhënies nga bankat.

### Ndryshimet rregullative nga Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë ka prezantuar katër ndryshime rregullative, për të rritur huadhënien nga bankat, të cilat në përgjithësi janë mirëpritur nga bankat.

Kështu, bankat mirëpritën uljen (në zero) të koeficienteve të rrezikut të aplikuara në huatë e reja, në rast se bankat do të rrisin huadhënien brenda intervalit 4% -10%. Kjo masë u jep mundësi bankave të rrisin aktivitetin e tyre huadhënës, pa nevojën e injektimit të kapitalit shtesë. Bankat, gjithashtu mirëpritën ndryshimet rregullative që do të lehtësojnë dhe nxisin më tej ristrukturimin nga bankat të huave për klientët e mirë, por në vështirësi të përkohshme.

Po kështu, reduktimi i raporteve minimale të likuiditetit, do të çlirojë më shumë fonde në dispozicion të huadhënies. AAB thekson se, në mënyrë që të arrihet efekti i prituri si dhe të mbështetet konkurrenca e ndershme, kjo masë duhet të zbatohet njësoj për të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri.

Nga ana tjetër, rritja e koeficientit të rrezikut (në 100%) për investimet jashtë vendit pritet të ketë pak ose aspak efekt në rritjen e huadhënies. Investimet jashtë vendit janë një aktivitet jofitimprurës (apo edhe me humbje) për bankat. Bankat janë të kushtëzuara të investojnë likuiditetin në monedhë të huaj jashtë vendit, për shkak të mungesës së kërkesës për hua në monedhë të huaj, ndërkohë që bankat janë të angazhuara t'i zëvendësojnë këto investime jashtë vendit me projekte të shëndetshme huadhënieje.

### Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile

Ndryshimet e miratuara së fundmi nga Kuvendi, një pjesë e mirë e të cilave u propozuan nga AAB, në

bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare si: Banka Botërore dhe projektit të BE-së EURALIUS, synojnë zgjidhjen e disa nga çështjeve të rëndësishme që pengojnë procesin e ekzekutimit të kolateralit, dhe si pasojë të gjithë procesin e kreditimit të ekonomisë.

Këto ndryshime kanë për qëllim kryesisht të vendosin standardet ndërkombëtare ligjore në të cilat mbështetet biznesi dhe praktika bankare, për ekzekutimin eficient të titujve ekzekutive, duke reduktuar mundësinë e përdorimit të masave të jashtëzakonshme, siç është pezulimi i ekzekutimit, si të ishin masa të zakonshme. Këto ndryshime synojnë inkurajimin dhe rritjen e kreditimit, dukë krijuar siguri për të gjitha palët në treg dhe më tepër siguri për publikun investues (depozituesit).

### Fshirja e kredive të këqija

Fshirja e huave të këqija duhet të kuptohet qartë si një proces i mirëfilltë kontabël që ndërmerren bankat, në

AAB rithekson se bankat në Shqipëri janë të angazhuara të sigurojnë kreditimin e nevojshëm për ekonominë, si aktivitetet i tyre parësor dhe i natyrshëm, dhe për këtë nevojiten projekte të mira financimi nga bizneset vendase, si dhe një kuadër rregullativ i shëndoshtë, i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm.

përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe me rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Bankat krijojnë provizione në masën 100% për mbulimin e humbjeve nga huatë e këqija; fshirja e tyre nga librat kontabël është thjesht një procedurë kontabël, që nuk ndikon në të ardhurat e bankave, e aq më pak në detyrimet e debitorëve ndaj bankave.

Konflikti aktual qëndron në keqinterpretimin nga Autoritetet Tatimore, të kriterëve të parashikuara nga ligji për njohjen e huave të këqija, p.sh. shterimin e të gjitha veprimeve ligjore. Në mënyrë të gabuar, nuk merren në konsideratë provigjionimi i plotë për huatë e këqija nga ana e bankave, (ndryshe nga kreditorë të tjerë), apo procedurat shteruese juridike të cilat bankat ndjekin për mbledhjen e tyre, si marrja e urdhrat të ekzekutimit nga gjykata dhe ndjekja nga përmbarimi. Në këtë këndvështrim, njohja e huave të këqija mund të zgjasë për vite, duke ndikuar në cilësinë e portofolit të huave dhe likuiditetin që disponojnë bankat për hua.

Bankat nuk po synojnë e as po propozojnë një fshirje masive të huave të këqija përtej rregullave përkatëse, por kërkojnë një zgjidhje afatgjatë përmes ndryshimeve ligjore të tilla që të mos lihet hapësirë për spekulime dhe keqinterpretim mbi specifikat përkatëse të kontratave të huasë bankare.

Në përfundim, AAB rithekson se bankat në Shqipëri janë të angazhuara të sigurojnë kreditimin e nevojshëm për ekonominë, si aktivitetet i tyre parësor dhe i natyrshëm, dhe për këtë nevojiten projekte të mira financimi nga bizneset vendase, si dhe një kuadër rregullativ i shëndoshtë, i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm. Sigurisht, kjo paketë e re ndryshimesh ligjore e rregullatore është shumë e domosdoshme, por përtej tyre realiteti i përditshëm është i ndërlikuar për nxitjen e huadhënies për ekonominë...jo vetëm nga bankat.

## FATCA<sup>1</sup> - LIGJI “PËR PËRPUTHSHMËRINË E PAGIMIT TË TAKSAVE PËR LLOGARITË E ÇELURA NË VENDET E HUAJA”



**nga Rozeta KOKALARI**  
Drejtuuese e Departamentit të  
Përputhshmërisë,  
PPP dhe investigimit të mashtrimeve  
Raiffeisen Bank Albania

FATCA është një moment i rëndësishëm zhvillimi në ecurinë e përpjekjeve të SHBA-së për të përmirësuar sistemin e pagimit të taksave, duke përfshirë në të aktivet e huaja financiare, si dhe llogaritë “offshore” të shtetasve amerikanë. Në këtë mënyrë, SHBA synon të shmangë evazionin fiskal. Kështu, FATCA do t’u kërkohej institucioneve financiare të huaja, të quajtura ndryshe dhe FFI<sup>2</sup> (konsiderohen të tilla të gjitha ato institucione që nuk janë amerikane) të raportojnë në Autoritetin e Tatim-Taksave në SHBA (IRS), informacionin për llogaritë e çelura nga taksapaguesit amerikanë, ose llogari të enteve, në të cilat taksapaguesit amerikanë kanë interesa të konsiderueshme pronësie.

Qëllimi i FATCA-s është të identifikohen dhe të raportohen të gjitha të ardhurat e taksueshme të qytetarëve amerikanë, për të shmangur evazionin fiskal, e në raste të caktuara, të mbahet një taksë 30% mbi këto të ardhura. Për këtë arsye, Departamenti Thesarit të

Autoritetet në Shqipëri nuk e njohin zyrtarisht FATCA-n dhe nuk kanë filluar diskutime për të nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe IRS-së. Kjo i çliron bankat në Shqipëri nga detyrimi për të qenë në përputhje me këto kërkesa.

SHBA-ve ka filluar bisedime me mbi 50 autoritete në botë, për të bërë të mundur zbatimin e FATCA-s. Disa shtete, si: Britania e Madhe, Spanja, Franca, Gjermania, Italia, Zvicra dhe Japonia kanë nënshkruar gjatë vitit 2012 marrëveshje ndërqeveritare me IRS-në. Shtete të tjera, si: Austria, Rusia, Hungaria, Polonia, Çekia, Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia kanë filluar bisedimet për marrëveshje ndërqeveritare, gjë që e bën më të lehtë zbatimin e FATCA-s. Sipas FATCA-s, institucioneve të huaja financiare (FFI) do t’u kërkohej të nëns-

hkruajnë një marrëveshje deklarimi me IRS-në. Në qoftë se një institucion financiar (FFI) refuzon të nënshkruajë marrëveshjen, FFI (dhe klientët e tij) do të jenë subjekt i një takse ndalimi ose mbajtje në llogari prej 30% të të gjitha interesave, dividendëve dhe shitjeve, të cilat rrjedhin nga të ardhura me burim në SHBA.

Në vijim, të gjithë institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilat i kanë qendrat e tyre në vende të BE-së, e që kanë marrë përsipër që të jenë në përputhje me FATCA-n, u kërkohej që të jenë në përputhje me kërkesat e saj. Me anë të kësaj marrëveshjeje u kërkohej të gjithë FFI-ve të identifikojnë klientët amerikanë dhe t’i raportojnë ata në bazë vjetore në IRS. Kjo do të thotë që institucioneve të huaja financiare, u kërkohej të:

- krijojnë dhe zbatojnë të gjitha proceset e nevojshme, për të kryer identifikimin/klasifikimin e klientëve, siç kërkohej nga IRS-ja;
- sigurojnë ruajtjen e përshtatshme të të dhënave përkatëse;
- kryejnë ekzaminimin e kërkuar për klientët;
- përgatiten për raportimin e taksës së ndalimit.

### Pengesat për zbatimin e FATCA-s në Shqipëri

Autoritetet legjislative dhe ekzekutive në Shqipëri nuk e njohin zyrtarisht FATCA-n dhe as nuk kanë filluar diskutime për të nënshkruar një marrëveshje

Situata është më e ndërlikuar për bankat në Shqipëri, me qendër në vendet e BE-së, të cilat kanë marrë përsipër të jenë në përputhje me FATCA-n. Prej tyre pritet që të jenë në përputhje me FATCA-n, por mungesa e një baze ligjore vendase e bën të vështirë zbatimin e kërkesave të saj.

<sup>1</sup> FATCA - Foreign Account Tax Compliance Act.

<sup>2</sup> Foreign Financial Institution.





## SHQIPËRIA DHE BAZEL II: SA AFËR JEMI?



**nga Ermira CURRI, MBA**  
Përgjegjëse e Zyrës së Rregullimit,  
Departamenti i Mbikëqyrjes  
BANKA E SHQIPËRISË

Që me krijimin e Komitetit të Bazelit në vitin 1974, pas shumë shqetësimeve serioze në monedhën ndërkombëtare dhe tregjet e njohura bankare, si p.sh.: rënia apo dështimi i Bankhaus Herstatt në Gjermani, sollën futjen e një sërë standardesh ndërkombëtare për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen bankare. Në tërësinë e këtyre standardeve të njohura dhe të zbatueshme edhe nga Shqipëria, do të veçonim Standardet e kapitalit dhe vlerësimit të tij, të njohura si Marrëveshja e Bazelit për kapitalin. Kjo marrëveshje u shpall zyrtarisht në korrik të vitit 1988 dhe njihet si Marrëveshja e 1988-ës. Marrëveshja, në funksion të vlerësimit të rrezikut të besueshmërisë sugjeronte një standard minimal të kapitalit prej 8 për qind (aktualisht për Shqipërinë ky raport në nivelet e tij minimale kërkohet të jetë 12 për qind) - kjo duke filluar nga fundi i vitit 1992. Nga viti kur u shpall kjo marrëveshje, kapitali i bankave dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u rritën në përgjithësi, madje në mënyrë të konsiderueshme. Fakt është që edhe me disa ndryshime të saj, marrëveshja nuk pengoi zhvilli-

Banka e Shqipërisë synon përshtatjen e metodave standarde për rrezikun e besueshmërisë dhe të tregut, si dhe të metodës së treguesit të thjeshtë dhe asaj standarde për rrezikun operacional, për llogaritjen e kërkesave për kapital nga bankat, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave të tyre për kapital, për monitorimin kryesisht të këtyre rreziqeve.

met e tregut bankar dhe nuk mund të shihej e shkëputur nga zhvillimet e rëndësishme financiare, që ndikojnë në veprimtarinë e bankave, por që në vazhdimësi filluan të prezantonin një profil rreziku të ndryshëm nga ai çfarë përshkruante kjo Marrëveshje. Kështu, ndërsa rritej konvergjenca e aktiviteteve financiare, zhbëheshin kufijtë tradicionalë midis veprimtarisë bankare dhe asaj në letrat me vlerë, sigurimeve etj. Gjithashtu, konsolidimi i sektorit financiar që diktohej nga rritja e kërkesës së klientëve për shërbime financiare të integruara dhe rritja e presionit të aksionarëve për të

shtuar fitimet po bëheshin gjithnjë e më evidente nëpërmjet shkrirjeve e blerjeve, aleancave strategjike dhe investimit të kapitaleve të përbashkëta në institucionet financiare në botë.

Kjo marrëveshje përqendrohej vetëm në rrezikun e besueshmërisë, që nuk është më një nga rreziqet e vetme të rëndësishme me të cilët përballen bankat. Përveç këtij rreziku bankat përballëshin në veprimtarinë e tyre të përditshme me një sërë rreziqesh, si: rreziku i tregut, i normave të interesit, i likuiditetit, operacional, ligjor, i reputacionit, ai strategjik, e për më tepër që bankat mund të përballen edhe me rreziqe të paparashikuara. Këto e të tjera zhvillime diktuan në vijim nevojën e rishikimit dhe përshtatjes së rregullave dhe metodologjive të mbikëqyrjes bankare, për t'i ardhur më së miri në ndihmë sistemit bankar dhe për të arritur objektivat e saj strategjike, për sigurimin e stabilitetit financiar. Kështu, Komiteti i Bazelit publikoi fillimisht në qershor të vitit 2004<sup>1</sup> kuadrin e ri e quajtur Marrëveshja e re e kapitalit, ose e njohur ndryshe Bazel II. Dihet se Bazel II përbëhet nga tre shtylla kryesore: (I) kërkesat për kapital për rrezikun e besueshmërisë, të tregut dhe atë operacional, (II) rishikimi i procesit të mbikëqyrjes dhe (III) disiplina e tregut. Ndërsa shtylla e parë trajton për herë të parë kërkesat e autoritetit mbikëqyrës edhe për rrezikun operacional, është shtylla e dytë ajo që

Projekti i Bankës së Shqipërisë shihet si mundësi për bankat, për përsosjen e mëtejshme të sistemeve të administrimit të rrezikut dhe të llogaritjes së nevojave më të kalibruara të kapitalit, si dhe siguron një lidhje racionale të kapitalit të bankës me profilin e rreziqeve të saj.

<sup>1</sup> Idetë për Bazel II u hodhën nga Komiteti i Bazelit që në vitin 1999.

# KREDI PËR SHTËPI

NORMË  
INTERESI  
**6%**



## ZGJIDHENI SHTËPINË ME ZEMËR DHE BANKËN ME MENDJE

VITI I PARË 6% FIKS. NË VAZHDIM EURIBOR + 4.5%, MIN 6%.  
OFERTA ËSHTË E VLEFSHME PËR PERIUdhËN 8 TETOR 2012 - 31 MARS 2013.

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



**SOCIETE GENERALE  
ALBANIA**

Banka e Shqipërisë, me lançimin e direktivës së IV të kapitalit do të mundësojë përshtatjen e kërkesave për kapitalin mbikëqyrës (rregullator), në kuadrin mbikëqyrës që fokuson këtë element të rëndësishëm të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe të përfshirjes së disa elementëve të tjerë, që lidhen me monitorimin e rrezikut të likuiditetit.

thekson se çdo bankë duhet të ketë procese të brendshme të fuqishme, që masin mjaftueshmërinë e kapitalit të saj, bazuar në një vlerësim të plotë të rreziqeve të bankës, si dhe shtylla e tretë, që synon të inkurajojë disiplinën në treg, përmes përcaktimit dhe publikimit të një tërësie informacionesh nga bankat, me qëllim që publiku të informohet në mënyrë të mjaftueshme për rreziqet ndaj të cilave ekspozohen bankat, proceset e vlerësimit të tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me mjaftueshmërinë e kapitalit apo elementë përbërës të tij.

### Shqipëria dhe qasja ndaj Bazel II. Po Bazel III?

“Roadmap” (harta e rrugës) së Shqipërisë (pra e Bankës së Shqipërisë), është ajo graduale drejt përafrimit me Bazel II dhe direktivat europiane, për veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mjaftueshmërinë e kapitalit, si një qasje e zgjedhur nga autoriteti mbikëqyrës e që konsideron zhvillimin dhe nevojat e sistemit bankar shqiptar. Kjo qasje do të nisë fillimisht me adoptimin e metodave standarde<sup>2</sup> të matjes, vlerësimit dhe monitorimit të rrezikut, duke vijuar në periudhën afatmesme edhe me modelet e brendshme dhe ato të avancuara të matjes, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve. Banka e Shqipërisë, ka lançuar së fundi (shkurt 2013) për diskutim me industrinë bankare, projektin e rregullores së re “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, si rishikim

tërësor të rregullores ekzistuese, nën dritën e Bazel II. Projekti synon përshtatjen e metodave standarde për rrezikun e besueshmërisë dhe rrezikun e tregut, si dhe të metodës së treguesit të thjeshtë dhe asaj standarde për rrezikun operacional për llogaritjen e kërkesave për kapital nga bankat, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave të tyre për kapital për monitorimin kryesisht të këtyre rreziqeve, duke siguruar në çdo rast nivelet e kërkuara të këtij raporti (12 për qind). Projekti është asistuar nga Banka e Italisë, në kuadrin e një programi dy-vjeçar binjakëzimi, krijon mundësinë për një qasje më të përafërt të kuadrin tonë rregullativ mbikëqyrës, me *acquis communautaire*<sup>3</sup>. Po kështu, projekti lançohet në këtë periudhë, që gjykohet si një periudhë e përshtatshme, pas së cilës ky standard (mar-rëveshje e kapitalit) kaloi testimin në vendet dhe bankat që janë aktive në tregjet ndërkombëtare dhe për të cilat ai ishte dizenuar, duke krijuar një pamje të plotë me të gjitha anët pozitive dhe negative të dëshmuara nga zbatimi në praktikë i tij.

Projekti shihet si mundësi për bankat, për përsosjen e mëtejshme të sistemeve të administrimit të rrezikut dhe të llogaritjes së nevojave më të kalibruara të kapitalit (ekonomik). Qasja që sjell në këtë projekt Bazel II siguron një lidhje racionale të kapitalit të bankës me profilin e rreziqeve të saj, e konkretisht trajton kërkesa e rregulla të autoritetit mbikëqyrës, kryesisht lidhur me:

- metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e besueshmërisë dhe rrezikun e palëve të treta (kundërpartisë);
- prezantimin e konceptit të Institucionit të Jashtëm të Vlerësimit të Kreditit (ECAI) dhe Agjencisë së Kreditimit të Eksporteve (ECA) dhe përdorimin e vlerësimeve të tyre sipas klasave përkatëse të ekspozimit;
- prezantimin e një numri më të zgjeruar klasash ekspozimi si dhe parimet dhe rregullat për përlllogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi;
- parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes së rrezikut të

besueshmërisë;

- titullizimin dhe llogaritjen e vlerës së ekspozimeve për titullizimet - kërkesat minimale për njohjen e transferimit të pjesës së konsiderueshme të rrezikut të besueshmërisë dhe për llogaritjen e shumave të ekspozimit të peshuar me rrezik e të tjera lidhur me titullizimet;
- metodën e treguesit të thjeshtë dhe metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun operacional (të patrajtuar më parë në kërkesat e autoritetit);
- metodën standarde të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e tregut;
- kërkesat e autoritetit mbikëqyrës për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve;
- publikimin nga ana e bankës, të informacionit, që lidhet me mjaftueshmërinë e kapitalit për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e disiplinës së tregut.

Në vijim, projekti do të para-prihet dhe nga një diskutim paralel me grupin ad-hoc të krijuar më parë nëpërmjet AAB-së, me qëllim ndarjen e eksperiencave me bankat e mëdha që kanë mëmat e tyre në vendet e BE-së dhe me bankat e vogla, lidhur me kostot që rrjedhin nga ky proces. Aktualisht, mësimet e krizës së vitit 2008 nxorën në pah nevojën për rishikimin e Bazel II, që sot në termat e një kuadri të rishikuar njihet si Bazel III (ose direktiva IV e kapitalit) dhe që kryesisht mbart rishikime të kërkesave të kapitalit për qëllime të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, të kërkesave më të kujdesshme për njohjen e elementeve përbërës të kapitalit mbikëqyrës (rregullator) etj. Banka e Shqipërisë, me lançimin e direktivës së IV të kapitalit do të mundësojë përshtatjen e kërkesave për kapitalin mbikëqyrës (rregullator), në kuadrin mbikëqyrës që fokuson këtë element të rëndësishëm të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe të përfshirjes së disa elementëve të tjerë, që lidhen me monitorimin e rrezikut të likuiditetit.

<sup>2</sup> Bazel II krijon hapësirë për përshtatjen nga metodat më të thjeshta te ato më të përparuara, duke krijuar mundësinë, ashtu si në rastin e sistemit bankar shqiptar, të përshtatjeve graduale me fillësë metodat e thjeshta, si dhe për sa kohë zbatimi i plotë i tij (përfshirë dhe metodat e avancuara dhe elementë të tjerë të tij) nuk është i detyrueshëm si për vendet anëtare të BE-së.

<sup>3</sup> Banka e Shqipërisë që me lançimin e Bazel II dhe direktivave europiane ka zbatuar disa përafrime të pjesshme në kohë të tyre, që gjejnë zbatim në ligjin për bankat dhe kuadrin rregullativ mbikëqyrës, kryesisht për administrimin e rrezikut të besueshmërisë, për kërkesat minimale të publikimit të informacionit, drejtimin e përgjegjshëm të bankave, rishikimin e procesit të mbikëqyrës etj.

## NDRYSHIMET E REJA NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE –MUNDËSI PËR EKZEKUTIME TË DETYRUESHME MË EFICIENTË

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, të sapomiratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, synojnë shkurtimin dhe thjeshtimin e procedurave të ekzekutimit të kolateralit, për zbatimin më efektiv dhe lehtësimin e procedurave që ndiqen nga qytetarët

**nga Ejvis NDONI**  
Departamenti ligjor,  
Raiffeisen Bank

Me fillimin e aktivitetit të përmbarrimit privat në Shqipëri filloi një “epokë e re” në ekzekutimin e detyrueshëm të huave me probleme. Përmbarruesit gjyqësorë-privatë dukshëm rritën cilësinë e këtij procesi, duke u bërë realisht proaktivë në ekzekutimin e titujve ekzekutive. Ky ndryshim cilësor në këtë drejtim nxori në pah, përveç domosdoshmërisë së një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të drejtë edhe nevojën e disa përmirësimeve në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, të cilat lidhen drejtpërdrejt me procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë të bankave.

Po pse bëhet një diferencim midis huadhënësve të tjerë dhe bankave? Banka përveçse është një shoqëri private administron dhe mbështetet në të ardhurat dhe kursimet e publikut të gjerë dhe pikërisht për këtë arsye dhe huat bankare, e rrjedhimisht ecuria e tyre, praktikisht diferencohen (që në vitin 2007 me anë të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese), duke u konsideruar një “interes i lartë publik”. Është pikërisht ky këndvështrim që, bankat nëpërmjet diskutimit të vazhdueshëm në Komitetin Ligjor të tyre pranë AAB, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me projektin e EURALIUS dhe bashkëpunimin e ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, kërkuan dhe propozuan disa përmirësime në Kodin e Procedurës Civile. Të gjitha diskutimet dhe propozimet në janar të 2013-ës u finalizuan me projektligjin: “Për disa shtesa dhe ndryshime në

Ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me shfuqizimin e të drejtës së gjykatave për të ndërhyrë në mekanizmin e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv, siç është huaja bankare, për të cilin është dhënë një urdhër ekzekutimi.

ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, tanimë i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Paketa e re ligjore synoi ndër të tjera dhe një përmirësim në drejtim të regjistrimit të seancave gjyqësore me metodën “audio recording”. Regjistrimi audio në gjykata mundëson regjistrimin e të gjithë komunikimit verbal që ndodh gjatë seancave gjyqësore dhe siguron ridëgjimin e mëvonshëm të këtij komunikimi, nëse do të jetë e nevojshme. Ky sistem ndikon në rritjen e transparencës dhe administrimit të proceseve gjyqësore (aktet procedurale, njoftimet dhe afatet). Në këtë kuadër, dhe në vijim

të analizimit të praktikës ndërkom-bëtare mbi realizimin e njoftimeve në proceset gjyqësore, tashmë dispozitat ligjore përfshijnë dhe mënyrat e reja të komunikimeve elektronike, siç janë p.sh.: adresat elektronike, thirrjet telefonike, apo nëpërmjet një mesazhi të shkruar në telefon.

Por ato çka janë më të rëndësishme për bankat janë ndryshimet në nenet që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë të bankave, si vijon:

- Ndryshimet në paketën ligjore synojnë rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të kolateralit, me qëllim përshejtimin e ekzekutimit, që është mekanizmi kryesor procedural për ekzekutimin e huave me probleme. Konkretisht, sipas shkronjës “b” të Nenit 206, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin me anë të një mase parandaluese të urdhëruar në një padi, si vijon: “Për të zvogëluar mundësinë e gjykatës për të ndërmarrë masa të cilat kundërshtojnë veprimet e përmbarruesit, janë propozuar ndryshimet në nenin 205/1 dhe nenin 206, shkronja “b” me këtë përmbajtje: “Nëpërmjet masave të tjera të marra nga gjykata, përveç kundërshtimit ndaj veprimeve të përmbarruesit, ndaj të cilit nuk mund të merren masa për sigurimin e padisë” etj.”
- Ndryshimet në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, ka të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtën e ristrukturimit të huave, duke ia hequr gjykatës këtë të

drejtë në rastin e huave bankare. Një masë e tillë, e miratuar sipas propozimit të AAB-së, do të ketë ndikim të rëndësishëm në procesin e ristrukturimit, duke i dhënë bankave një ndihmesë të çmuar në këtë drejtim.

- Ndryshimet e kërkuara në përmirësimin dhe saktësimin e nenit 577 të Kodit të Procedurës Civile, lidheshin me përqindjen e uljes së vlerës së sendit në ankandin e dytë. Kjo, pasi praktika ka treguar se përmbaruesit e interpretojnë në mënyra të ndryshme këtë nen. Një pjesë e tyre e ul çmimin në pjesën e dytë të ankandit me një tjetër 20 për qind nga vlera e ankandit të parë, prandaj në ankandin e dytë çmimi i sendit është 64 për qind më i ulët se çmimi i tij fillestar, ndërkohë që një tjetër interpretim vëren se vlera e sendit mund të ulet deri në 80 për qind nga vlera fillestare e tij. Në propozimet e AAB-së u kërkua gjithashtu dhe ulja e vlerës me 50 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë, duke vendosur një mesatare të pranueshme për debitorin dhe kreditorin, duke bërë më të qartë vlerën (çmimin) e sendit me të cilin do të fillohet në ankandin e dytë. Gjithsesi, ndryshimi i kërkuar nuk u konsiderua

nga ligjvënësi, por ka ndryshuar niveli i përqindjes së uljes së çmimit (nga 20% në 30%).

- Një tjetër ndryshim i propozuar në nenin 609, lidhej me mospëzullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga ankimi ndaj veprimeve, ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor, duke hequr të drejtën e gjykatës për të vepruar ndryshe. Ligjvënësi këtu vendosi një zgjidhje të ndërmjetme, ku mund të vendoset pezullimi kundrejt një garancie, por tashmë ka edhe një afat të përcaktuar për këtë pezullim.
- Shtesa e propozuar në nenin 568, u miratua ashtu siç u propozua nga bankat (AAB), duke synuar një transparencë më të madhe të zhvillimit të ankandëve, që është në përputhje të plotë me qëllimin e AAB-së për krijimin e portalit të ankandëve.
- Në nenin 610, pavarësisht nga kërkesa e AAB-së që të mos jepej mundësia të ankimohej procedura e përmbarimit, përsëri ligjvënësi ka lejuar një procedurë e tillë, por me një afat deri në 20 ditë.

Në këtë kuadër, si dhe duke konsideruar nga njëra anë rritjen e vazhdueshme të huave me probleme dhe nga ana tjetër nevojën për rritjen e kreditimit të ekonomisë nga ana e

bankave, këto ndryshime gjykohen shumë e rëndësishme nisur si një nevojë urgjente ekonomike, brenda sistemit bankar shqiptar.

Praktika e deritanishme, si edhe dinamikat e tregut tregojnë se çmimi me të cilin fillohet ankandi i dytë është shumë i lartë për të realizuar shitjen e pronës, veçanërisht po të mbahet parasysh që përcaktimi i drejtë i çmimeve të tregut është i vështirë në kushtet aktuale. Për rrjedhojë ankandet shpesh dështojnë si pasojë e këtij çmimi jo realist, me të cilin fillon ankandi i dytë.

## Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi në Kodin e Procedurës Civile

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi së fundi paketën e propozuar të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile (KPC), që në një pjesë të mirë morën parasysh propozimet e industrisë bankare, si më poshtë:

1. Në nenin 517, paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë: *“Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt për dhënien e kredisë bankare. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankimi i veçantë.”*
2. Në nenin 568, në fund të fjalisë së parë të paragrafit të parë shtohen fjalët: *“si dhe për 5 ditë me radhë në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh”*.
3. Në nenin 577, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë: *“Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 568 të këtij Kodi dhe*

*zhvillohet 30 ditë nga e nesërmja e datës së caktimit të çmimit të ri.”*

4. Në nenin 609 bëhen këto ndryshime: *a) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë: “Në këto raste, gjykata mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit, vetëm me garanci dhe për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, përveç rasteve kur gjykata, brenda këtij afati, vendos me vendim përfundimtar pranimin e padisë. Me kalimin e afatit 3-mujor, ose kur gjykata, brenda këtij afati, vendos refuzimin e padisë ose pushimin e gjykimit të saj, masa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit konsiderohet e rënë nga fuqia.”*
5. Në fund të nenit 610 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje: *“Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankimi i veçantë.”*

VISA Classic  
"My Way"



**...çdo gjë që dëshiron  
dhe zgjidh si të paguash!**

**Blini brenda dhe jashtë vendit dhe  
paguani me këste fikse mujore.**

[www.tiranabank.al](http://www.tiranabank.al)

PIRAEUS BANK GROUP

**TIRANA  
BANK**  
tani mundesh

## PRIRJET E REJA TË BANKINGUT QENDROR – MODERNIZIM APO SFIDË?



**nga Ela GOLEMI<sup>1</sup>**  
Anëtare e Këshillit Mbikëqyrës  
BANKA E SHQIPËRISË

Vazhdimi i krizës ekonomike e financiare ka shtyrë disa banka qendrore që përveç objektivit të tyre themelor, atë të dinamikës së inflacionit, të kujdesen njëherësh edhe për rritjen ekonomike. Zëvendësimi i politikës tradicionale njëobjektivëshe, të zbatuar nga shumica e bankave qendrore e që ka qëllim të vetëm ruajtjen dhe stabilitetin e çmimeve, me politikën e re dyobjektivëshe, ka çelur debate dhe shqetësime akademike për dizenjimin e një bankingu qendror realist dhe modern. Lëvizja e fundit e Bankës Qendrore të Argjentinës e ushqen akoma edhe më shumë këtë debat. Ligji i ri i Bankës Qendrore të Argjentinës, i miratuar në mars të vitit 2012, shkon përtej parimit dyobjektivësh dhe hap rrugën për një përpjekje shumëobjektivëshe. Ai hap një dritare të re diskutimi jo vetëm nëse përqsaja e re më e zgjeruar mund të kompromentojë koston e stabilitetit makroekonomik, por edhe nëse stili i ri i politikës monetare është me të vërtetë bindës. Për më tepër, në Europë dhe SHBA “artileria e rëndë”, Bernanke dhe Dragi, parapëlqen të mbajë norma të ulëta interesi për disa vite dhe të blejnë agresivisht instrumente financiarë të borxhit.

Arritja e objektivave të së ardhmes kërkon zgjedhje të mira dhe politika efektive dhe për këtë faktori human luan një rol kyç, pavarësisht asaj që thotë statuti.

Një pjesë e ekonomistëve të shquar kanë përshëndetur si lëvizjen argjentinase drejt përqsajes shumëobjektivëshe të bankës qendrore, ashtu dhe lëvizjet e Bernankes dhe Dragit. Në kushtet kur qeveritë janë të pafuqishme të menaxhojnë prodhimin dhe zhvillojnë tregjet e punës, ekziston një nocion i mbështetur së fundmi e i përhapur dhe nga media, se bankat qendrore mund të sigurojnë stabilitetin e çmimeve dhe të rivendosin kushtet e nevojshme për rritje ekonomike, apo të sigurojnë objektiva të tjerë fiskalë. Ky rast tregon qartazi se disa ekonomistë janë kthyer në maniakë të ligjeve dhe rregulloreve - lehtësimi fiskal në të shkuarën dhe lehtësimi monetar së fundmi, mund të zgjidhë proble-

Statuti i një banke qendrore nuk mund të tregojë nëse dhe kur duhet të kryhet politikë stimuluese monetare, as se si kjo politikë të koordinohet me politikën fiskale, as si të bëhet politikë monetare në kohën kur normat e interesit janë afër zeros dhe norma e borxhit publik është e lartë.

me përgjatë gjithë spektrit të ekonomiksit. Ndërsa sjellja vendimtare e “faktorit human”, apo zgjedhja inteligjente, po neglizhohet në mënyrë të konsiderueshme në modelet e sotme komplekse makroekonomike, në të cilat përpjekjet për të zgjidhur krizën e vështirë të papunësisë dhe sforcimet për të menaxhuar borxhin publik, përfaqësojnë në vetvete një sinjal të vështirësive serioze. Drejtimi i kujdesshëm është i domosdoshëm në kontekstin modern të sfidave globale makroekonomike, sepse realiteti kompleks kërkon zgjedhje të mençura, të sakta dhe masa të përshtatshme nga ana e bankierëve qendrorë dhe qeveritarët, të cilat shkojnë përtej politikave të thjeshta fiskale dhe monetare.

Reflektimi mbi “ekonominë ortodokse”, e cila fajëson hapur “rregullat” dhe e largon vëmendjen nga njerëzit, është i nevojshëm. Tashmë është e zakonshme që në rastet e krizave dhe trazirave financiare faji u vihet rregullave, duke e larguar atë nga njerëzit. Ne përballemi me çështje ekonomike shumëdimensionale dhe nuk është e drejtë që fajet për vështirësitë ekonomike aktuale t’i atribuohen sistemit të ligjeve të bankës qendrore, apo masave shtrënguese fiskale. Gjithashtu, duhet të ndërjegjësohemi se ekonomitë moderne nuk mund të zgjerojnë barrën e borxhit pafundësisht dhe as nuk mund të prishin skemën e menaxhimit të borxhit. Shikimi i problemeve të sotme nëpërmjet një mekanizmi të thjeshtë të një ligji të mirë të bankës qendrore, apo një politike fiskale ekspansioniste, që mund të sigurojnë

<sup>1</sup> Mendimet e shprehura janë të vetë autores dhe nuk shprehin mendimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.



gjithmonë arritje të suksesshme, është i gabuar. Kompleksiteti i ekonomisë së sotme kërkon jo vetëm përdorimin e instrumenteve të mira, rëndësinë e të cilave asnjë nuk e mohon, por dhe të dy elementëve të tjerë, që kanë marrë një vëmendje relativisht të vogël:

- (1) të gjykuarit sipas të shkuarës nuk të ndihmon në kuadër global të ekonomisë dhe zhvillimit financiar. Për shembull, Britania e Madhe kishte një borxh publik shumë më të lartë në të shkuarën sesa sot. Borxhi i saj arriti në 250% të PBB-së pas Luftës së Dytë Botërore, periudhë kjo që njihet si koha e lavdisë së saj nga pikëpamja e fuqisë. Gjithsesi, menaxhimi i borxhit sovran ka ndryshuar ndjeshëm; ajo çfarë ishte normale apo një borxh i qëndrueshëm në të shkuarën, është anormale në ditët tona;
- (2) faktori "human", që në të vërtetë është vendimtar në ditët e sotme. Mund të ndodhë që ligjet e mira të bankës qendrore, apo liria fiskale mund të menaxhohen keq dhe/ose mund të mos koordinohen. Asnjë ligj apo çfarëdo lloj statuti nuk mund të prezantojë automatikisht veprime të mira, apo të transformojë një politikë të dobët monetare dhe fiskale, ose mosrkoordimin e tyre, në diçka efektive për ekonominë.

Në rast neglizhimi të rolit të rëndësishëm të "smart decision", mjafton të kujtojmë se çfarë mund të ndodhte me gremien fiskale në SHBA, e cila përfaqësonte shkurtimin automatik të shpenzimeve dhe rritjen e taksave përgjatë një dekade. Nëse nuk do të shmangej përmes një ndërhyrje të mençur, do ta çonte SHBA-në hapa prapa në recesion, kur më shumë se

500 miliardë US\$ do të dilnin jashtë sistemit të saj ekonomik. Çfarë kuptimi do të kishte fuqizimi i bankave qendrore me një diapazon të gjerë objektivash, nëse ato nuk menaxhojnë dot zgjuarsisht paranë, nuk parashikojnë trazirat ekonomike dhe financiare? Pjesa e diskutueshme e debatit aktual është si mund të besohet se banka qendrore është gjithmonë e aftë të realizojë, sipas mandatit argjentinas, një "shpërndarje të barabartë" dhe "shpërndarje sektoriale të huas", pavarësisht kapacitetit të saj për t'u fokusuar plotësisht te problemet, për të kuptuar realitetet dhe dinamikat komplekse dhe për të vepruar në mënyrë të njëtrajtshme dhe sistematike? Si mund të imagjinohet që një ligj shumëobjektivësh të mundësojë realizimin e një politike racionale në vetvete dhe/ose t'i drejtojë bankierët qendrorë të vendosin si objektiv një nivel nominal të PBB-s, ashtu si Ben Bernanke dëshironte të prezantonte por nuk e prezantoi? Nuk mund të besohet se argumenti i Bernankes për të ndihmuar menaxhimin e borxhit publik nëpërmjet blerjes së 40 miliardë US\$ në muaj të instrumenteve financiarë në treg, të jetë në vetvete një sinjal se banka qendrore mund të stimulojë ekonominë dhe të hapë vende të reja pune, në çdo kohë që ajo dëshiron.

Nëse ligji i ri i bankës qendrore, si ai i adoptuar në Argjentinë, mekanikisht vendos një politikë monetare kundërciklike, siguron një diapazon të gjerë objektivash dhe një koordinim me politikën fiskale, zgjedh e vendos prioritete si dhe projektion veprimet e ardhshme, atëherë do të mjaftonte shtimi i një fjalie në statutin e çdo banke qendrore, për të arritur të gjitha objektivat e mundshme. Statuti i një banke qendrore nuk mund të

Drejtimi i kujdesshëm është i domosdoshëm në kontekstin modern të sfidave globale makroekonomike, sepse realiteti kompleks kërkon zgjedhje të mençura, të sakta dhe masa të përshtatshme nga ana e bankierëve qendrorë dhe qeveritarët, të cilat shkojnë përtej politikave të thjeshta fiskale dhe monetare.

tregojë nëse dhe kur duhet të kryhet politikë stimuluuese monetare, as si kjo politikë të koordinohet me politikën fiskale, as si të bëhet politikë monetare në kohën kur normat e interesit janë afër zeros dhe norma e borxhit publik është e lartë. Hipoteza e fundit është e një rëndësie të madhe, në rastin kur shohim bankat qendrore që ulin normat e interesit drejt zeros, në përpjekje për të stimuluar ekonominë, ndërsa deficitet fiskale dhe borxhet publike rriten në përmasa shqetësuese. Paradoksi këtu është se ushtrimet ekonometrike provojnë se multiplikatori i stimujve fiskalë rritet në rast se normat shumë të ulëta të interesit e humbin rolin e tyre për të influencuar pritjet e agjentëve ekonomikë, kështu që politika monetare bëhet një instrument i padobishëm. Për më tepër, nuk është reflektuar se si këto instrumente lehtësojnë ekonominë dhe sa të rëndësishëm janë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Politikat dhe strategjitë për rritje ekonomike nuk duhet të mjaftohen vetëm nëpërmjet vendosjes si një objektiv i dëshiruar në ligj. Arritja e objektivave të së ardhmes kërkon zgjedhje të mira dhe politika efektive dhe për këtë faktori human luan një rol kyç, pavarësisht asaj që thotë statuti. Gjithçka që na duhet për të mbështetur stabilitetin makroekonomik është një politikë monetare koherente e harmonizuar me politikën fiskale, por mbi gjithçka menaxherë të mprehtë të parasë dhe të financave publike.



## KRIZA FINANCIARE QIPRIOTE - BANKAT NËN PRESIONIN E TAKSIMIT TË DEPOZITAVE



**nga Prof. Dr. Adrian CIVICI**  
President & Drejtor i Shkollës  
Doktorale  
Universiteti Europian i Tiranës, UET

Qipro, një nga vendet më të vogla të BE-së e cilësuar shpesh si: "Zvicra e Mesdheut", u shfaq në muajt e parë të 2013-ës si i sëmundur i madh i radhës së Eurozonës. Situata financiare e ishullit rezultoi e mbushur me paqartësi e pikëpyetje shqetësuese. Një popullsi pak më shumë se 1 milion banorë dhe një ekonomi që përfaqëson vetëm 0.2% të PBB-së së Eurozonës, duket se po përbën "dhimbjen më të madhe të kokës" për liderët europianë dhe veçanërisht ata të Eurogrup-it. E gjashta në radhën e vendeve që po tronditin bazat e ndërtimit dhe të ardhmen e vetë projektit europian dhe atij të Euro-s (pas Irlandës, Spanjës, Portugalisë, Italisë dhe Greqisë, por edhe nën tryshninë e krizave të tjera në horizont për Slloveninë, e ndoshta Maltën dhe Luksemburgun); Qipro u shfaq si një rast akoma dhe më i ndërlikuar, po të kihet parasysh se në lojë u përfshinë thuajse të gjitha bankat e vendit. Specifika qipriote në rastin e bankave, qëndron në faktin se në këto banka është i angazhuar edhe një vend tjetër jashtë BE-së dhe Eurozonës: Rusia. Në raste të tilla, qarkullojnë dhe skenarë ekstremë, që e mendojnë Qipron totalisht të falimentuar dhe jashtë Eurozonës, megjithëse drejtuesit më

Nevoja për të gjetur shpejt paratë e nevojshme, duke evituar rregullimet fiskale afatgjata e të ndërlikuara, si dhe "qëllimi" që edhe investuesit e huaj e veçanërisht ata rusë të "detyrohen" të kontribuojnë për "parajsën fiskale qipriote", e detyroi BE-në të bënte një propozim që e "kalonte Rubikonin".

të lartë europianë tregohen të kujdesshëm, kur diskutohet për mundësinë e falimentimit të pakontrolluar të ishullit, apo një dalje e mundshme nga Euro, pasi si në rastin grek, kjo do të kishte pasoja të rënda për të gjithë Eurozonën. Edhe në këtë rast, në tavolinë u vu një "plan shpëtimi", që do të zbatohet duke filluar nga fundi i muajit maj 2013.

Duket se kriza e Qipros aleatin më të keq kishte kohën. Guvernatori i BQE-së, Mario Draghi, i ka rënë vazhdimisht sinjaleve të alarmit, pikërisht kundër prirjeve "pritëse e hezituese", në raport me marrjen e një vendimi të shpejtë final për "zgjidhjen e krizës qipriote". Nëse në muajt e ardhshëm

Duke vendosur taksimin e depozitave bankare mbi 100.000 euro që janë të garantuara, BE krijoi mjaft dyshime te besimi i depozituesve europianë. Ky precedent mund të shndërrohet në një element negativ, në raport me besueshmërinë politike të drejtuesve të lartë europianë.

nuk do të garantohet ndihma financiare e jashtme e kërkuar, vendi rrezikon falimentimin financiar duke e pasur të pamundur realizimin e pagesave dhe detyrimeve të kësaj natyre. Nevojat e ishullit për ta kapërcyer këtë gjendje, fillimisht, u përmboldhën në rreth 17 miliardë euro 7.5 miliardë për të mbuluar nevojat e financimeve e pagesave shtetërore dhe 10 miliardë Euro për të rikapitalizuar bankat. Por, kjo "paketë ndihmesh", ekuivalente me PBB-në vjetore të Qipros, e çoi menjëherë në 140% të PBB-së borxhin publik të ishullit, duke e bërë akoma më të destabilizuar situatën aktuale dhe atë perspektive ekonomiko-financiare. FMN-ja refuzon të angazhohet drejtpërdrejt dhe të ndihmojë vendet që kanë një nivel borxhi sovran mbi 120%, të PBB-së pasi e gjykon atë si një nivel mjaft të rrezikshëm, duke sugjeruar një "ristrukturim të plotë të borxhit" dhe një zhvlerësim të aktiveve të sektorit privat, ashtu siç ndodhi me rastin grek. Ndërkohë, edhe Eurogrup apo Gjermania, e refuzuan angazhimin e drejtpërdrejtë në ndihmë të Qipros, pa pjesëmarrjen e FMN-së. U kërkuar dhe një kontribut i Rusisë me 2.5-5 miliardë Euro, një plan konkret zvogëlimesh shpenzimesh buxhetore, realizimi i një programi intensiv privatizimesh, e mbi të gjitha një ngritje e përgjithshme e taksave, veçanërisht atyre mbi kapitalet dhe fitimin, në një vend që deri tani është konsideruar si "parajsë fiskale".

Por, në fund të muajit mars të këtij viti, kostoja e planit të shpëtimit të Qipros u rivlerësua në 23 miliardë Euro, nga 17 miliardë që ishte vlerësuar paraprakisht. Diferenca prej 6 miliardë Euro duhet të paguhet nga depozituesit e bankave qipriote dhe nga Shteti, i cili duhet të shesë një pjesë të rezervave të arit që disponon. Propozimi i fundit i ardhur nga Brukseli në fund të muajit mars është: vetëm 10 miliardë Euro ndihmë, në mënyrë që borxhi të mos kalojë tavanin e 120% të PBB-së, dhe 13 miliardë euro që mbeten duhet të sigurohen me "mënyra të tjera".

"Nyja gordiane" që ndërlikoi skenarët e zgjidhjes së problemit të paketës së ndihmës, është kushti i vendosur nga Brukseli për "reduktimin e sektorit bankar në Qipro, për vendosjen e një serie rregullash të forta kundër pastrimit të parave, e mbi të gjitha, vendosja e një takse mbi depozitat bankare". Eurogrup është shprehur qartë se kërkon që një pjesë të faturës së ndihmës të paguhet nga depozituesit e bankave të vendit. Klientela ruse do të jetë në vijën e parë të frontit, pasi megjithëse banka qendrore qipriote nuk lejon publikimin e kombësisë së depozituesve, vlerësohet se ajo ka të depozituar rreth 18-25 miliardë Euro në ishull, kur dhe investimet ruse në Qipro janë në vend të parë, me rreth 250 miliardë Euro. Qipro duket e gatshme të pranojë një auditim më rigoroz evropian, lidhur me pastrimin e parave dhe depozitave "problematike" të strehuara në bankat e saj, por ajo u shpreh fillimisht kundër taksës mbi depozitat, duke e cilësuar atë si të papranueshme e me pasoja katastrofike, të mishëruara në një hemorragji bankare të paprecedentë. Debatu u zhvillua në dilemën: "nëse do të pranohet taksimi i depozitave, duke filluar nga shuma 20.000 Euro në masën 6.75%, apo do të taksohen vetëm depozitat mbi 100.000 Euro në masën 9.9%?"

Në rastin e Greqisë, Portugalisë, Irlandës apo Spanjës nuk u shkua kaq larg dhe Eurozona i mori vetë përsipër përgjegjësitë, ndërkohë që në rastin "Qipro" u kërkua dhe kontributi i Ruisë në një shumë nga 2.5 deri në 5 miliardë Euro. Mediat qipriote evidentuan mjaft ide e mendime nga Qeveria, që propozonte emetimin e obligacioneve të reja, ristrukturimin e bankave, politika specifike për të tërhequr më shumë investime të huaja veçanërisht ruse, shfrytëzimin

më përparësi të burimeve energjetike potenciale etj. Parlamenti qipriot fillimisht ishte unanimit në refuzimin e propozimit për taksimin e depozitave, ndërkohë që dhe qytetarët u rreshtuan po kaq unanimit në vendimin e Parlamentit me moton: "Qipro i takon popullit të saj... një popull i bashkuar nuk mposhtet kurrë etj". Por përtej "një plani specifik shpëtimit për Qipron", me të cilët tashmë Eurozona, BQE apo FMN u "mësuan" këto vitet e fundit, ajo që shkaktoi debatin dhe habinë më të madhe ishte propozimi për zbatimin e "taksës mbi depozitat", formë apo model kontributi kombëtar, i pazbatuar ndonjëherë në këtë formë e në këto përmasa. Nevoja për të gjetur shpejt paratë e nevojshme, duke evituar rregullimet fiskale afatgjata e të ndërlikuara, si dhe "qëllimi" që dhe investuesit e huaj e veçanërisht ata rusë të "detyrohen" të kontribuojnë për "parajsën fiskale qipriote", e detyroi BE-në të bënte një propozim që thyejnte një tabu, që e "kalonte Rubikonin", aq më tepër që në Eurozonë depozitat bankare janë të garantuara më masën 100.000 Euro. Argumenti mbizotërues që "justifikonte" një masë të tillë drastike, bazohej në specifikën e ekonomisë qipriote dhe rolin e sistemit bankar në këtë ekonomi, në mënyrë të veçantë përqindjet e interesit mjaft tërheqëse që ky sistem ofron për depozitat, si dhe prezencën e madhe ruse në këtë sistem. "Pjesa më e madhe e pasurisë së Qipros janë bankat, ndaj u takon atyre që të kontribuojnë në zgjidhjen e ngërçit", deklaroi Presidenti i Eurogrupit, Jeroen Dijsselbloem. Përballë frikës se rasti qipriot mund të "krijonte një precedent paniku bankar", apo mund të "shkaktonte një infektim në shkallë europiane", Eurogrupi garanton se "kjo masë gjykohet si unike vetëm për Qipron, si një rast i izoluar specifik".

Megjithatë, në Europë ky është rasti i tretë që ndodh. Në vitin 1992, kur Italia po kalonte një krizë të rëndë financiare dhe duhej patjetër të ulte sa më shpejt nivelin e borxhit publik, u vendos një taksë prej 0.6% mbi të gjitha depozitat bankare italiane, si pasojë e së cilës u arrit të mblidhehin rreth 15 miliardë Euro (30 mijë miliardë Lireta të kohës). Kjo masë u pranua nga të gjithë italianët, si "një përpjekje kolektive për të shëndoshur financat e vendit... dhe jo si një konfiskim fiskal", megjithë pasojat e saj të rënda në nxitjen e largimit të

kapitaleve nga Italia. Këtu futet dhe "rasti i Norvegjisë" i vitit 1936, kur Qeveria norvegjeze vendosi të taksojë interesin nga depozitat bankare në masën 25%, me argumentin se "kishte nevojë të taksonte më shumë kapitalin" që nuk kontribuonte sa duhet në buxhetin e shtetit. Por edhe kjo taksë pati jetë shumë të shkurtër, pasi Qeveria ju tremb ritmit të lartë të zvogëlimit të depozitave dhe largimit të kapitaleve. Tipik në këtë drejtim është dhe rasti i Zimbabves, që në vitin 2008 konfiskoi të gjitha depozitat në llogari rrjedhëse në valuta të huaja, veprim që shkaktoi kritika të ashpra, sidomos nga FMN. Pikërisht, për këto arsye e për këtë eksperiencë, jo vetëm në Qipro, por dhe në rrethe ekspertësh financiarë e bankarë, një propozim i tillë evropian u pa me dyshim e skepticizëm, si një "konfiskim fiskal që prek jo vetëm depozituesit e mëdhenj, qofshin këta dhe rusë, por mbi të gjitha prek në masë "depozituesit normalë", që nuk kanë asnjë lidhje apo faj për menaxhimin e keq të financave publike dhe situatën e krizës së vendit".

Dështimi i planit "A" i la vendin një plani "B", të aprovuar nga ministri i Financave të Eurozonës, sipas së cilit Qipros do t'i akordohej nga Trojka (Komisioni Evropian, BQE dhe FMN), një ndihmë financiare prej 10 miliardë Euro (9 miliardë do të jenë kontributi i Eurozonës, nëpërmjet Mekanizmit Evropian të Stabilitetit, MES; dhe 1 miliard do të garantohet nga FMN-ja). Borxhi jepet për një periudhë kohore 15-20 vjeçare. Qipro, duhet të sigurojë nga ana e saj 13 mi-

"Nyja gordiane" që ndërlikoi skenarët e zgjidhjes së problemit të paketës së ndihmës është kushti i vendosur nga Brukseli për "reduktimin e sektorit bankar në Qipro, për vendosjen e një serie rregullash të forta kundër pastrimit të parave, e mbi të gjitha, vendosja e një takse mbi depozitat bankare".



liardë Euro të tjera, që mendohen të gjenden nga likuidimi i Bankës Laiki dhe taksat mbi depozitat mbi 100.000 Euro (10.6 miliardë Euro), nga rritja e taksave (600 milionë Euro), nga privatizimet (1.4 miliardë Euro), nga shitja e arit (400 milionë Euro), nga ristrukturimi i Bankës së Qipros etj. Plani i ndihmës i imponon Qipros, një reduktim drastik të sektorit të saj bankar gjigand, që me aktivitetet e tij në shumën 120 miliardë Euro, rezultojnë 7-8 herë më i madh se PBB-ja e ishullit. Objektivi i imponuar është që deri në vitin 2018, të realizohet përgjysmimi i këtyre aktiveve deri në 3.5 herë më të mëdha se PBB-ja. Qipro duhet të rrisë taksat, të shkurtojë shpenzimet publike dhe të zbatojë reforma të rëndësishme strukturore për të shëndoshur financat publike, në mënyrë që të garantojë shlyerjen e borxheve. Ajo duhet të kalojë nga një nivel borxhi prej 150% aktualisht, në një nivel prej 126% të PBB-së në vitin 2015 dhe 104% të PBB-së në vitin 2020.

### Tre "leksione" të rëndësishme për BE-në nga kriza bankare qipriote

1. Leksioni ekonomik: *"bllokimi që në zanafillën e tyre të modeleve financiare të rrezikshme"*. Pra ndalimi i çdo përpjekje për ngritjen dhe zhvillimin e modeleve bankare e financiare, që i lejojnë bankave të pranojnë si depozita

shuma marramendëse, që vijnë nga "klientë jashtë BE-së" si p.sh.: ata rusë, britanikë etj. Në rastin e Qipros, vlerësohet se depozitat me origjinë ruse përfaqësojnë 15-20 miliardë Euro nga 70 miliardë Euro që ishte totali i tyre. Sektori bankar qipriot u bë 7-8 herë më i madh se PBB-ja e ishullit, duke i shpëtuar çdo lloj kontrolli publik. Po t'i shtojmë këtij fakti dhe përqindjet shumë të larta të interesit që ofroreshin për këto depozita, atëherë Qipro mund të konsiderohej si një "parajsë e mirëfilltë fiskale brenda Eurozonës". Sipas J.D. Giuliani, president i Fondacionit, Robert Schuman: "integrimi dhe unifikimi i Eurozonës nuk mund të pranojë modele bankare e financiare të paqarta, që dëmtojnë gjithë ndërtesën e Euro-s".

2. Leksioni organizativ: *"domosdoshmërinë e unifikimit të supervizionit bankar dhe marrjen e vendimeve në eurozonë"*. Kriza qipriote dëshmoi se sa e rëndësishme dhe urgjente është transferimi i kompetencave mbikëqyrëse te Banka Qendrore Europiane. Harmonizimi i bashkimit monetar me bashkimin bankar kërkon eliminimin e "improvizimeve në gjetjen e zgjidhjeve të krizave që po vijnë njëra pas tjetrës, në vendet e Eurozonës". Sipas Sharon Bowles, Kryetare e Komisionit të Çështjeve

Monetare pranë Parlamentit Europian, "qytetarët dhe tregjet në Europë janë të çorientuar nga improvizimet e njëpasnjëshme të politikanëve të Eurozonës", duke provokuar perceptime të gabuara për qëndrime dhe vende të ndryshme të BE, siç janë p.sh.: ndjenjat antigjermane.

3. Leksioni politik: *"shmangia e precedentëve në ndërhyrjet ndaj bankave"*. Duke vendosur taksimin e depozitave bankare mbi 100.000 Euro që janë të garantuara, BE krijoi mjaft dyshime te besimi i depozituesve europianë. Ky precedent mund të shndërrohet në një element negativ, në raport me besueshmërinë politike të drejtuesve të lartë europianë. Në rastin e krizave të ardhshme, depozituesit europianë do të jenë gjithnjë e më të destabilizuar nga frika e vendimeve subjektive, që mund të prekin depozitat e tyre. Eliminimi i kësaj situatë kërkon hapa të shpejtë drejt një reforme radikale europiane në sferën e garancisë së depozitave bankare. Liderët europianë dhe veçanërisht ata të Eurozonës duhet të gjejnë një ekuilibër më transparent midis "prioritetit për të mos lënë vende që të braktisin Eurozonën dhe kostos financiare e politike të ndërhyrjeve e paketave të ndihmës" për vende të veçanta.

 SHTËPIAIME

KREDI PER SHTEPI



 **UNIONBANK**  
Banka që dua

**Nuk është ëndërr!**

**6.3%** ne Euro, **3 vjet** interes fiks i pandryshuar  
**5.3%** ne Euro nga bashkepunimi me  
30 kompani serioze ndertimi

## BKT



**BKT mbështet kompletimin e Laboratorit të Informatikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës**

BKT, në përputhje me politikën e saj të përgjegjshmërisë sociale në fushën e arsimit dhe edukimit, kompletoi Laboratorin e Informatikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, për t'u krijuar kushte sa më të mira studentëve të këtij fakulteti

## INTESA SANPAOLO BANK

Përgjegjësia sociale e korporatës është një nga konceptet themelore të Grupit Intesa Sanpaolo dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, si pjesë e tij, vazhdimisht shton përpjekjet e saj për të ndërtuar një strategji të integruar që përfshin të gjithë aksionarët. Duke synuar jo vetëm thjeshtësinë në veprime, por dhe efikasitetin në përfitimet që ato sjellin, banka beson se "Përgjegjësia Sociale e Korporatës nis me punonjësit e saj", ndaj promovon dhe zgjeron angazhimin vullnetar të tyre në fushën sociale dhe atë humanitare.

**Dhurimet e punonjësve për fëmijët jetimë e familjet në nevojë, në jetimoret e qendrat shtetërore ditore e rezidenciale në Tiranë, Durrës e Shkodër**

Dashuria e përkujdesja janë ndjenjat që ju mungojnë më shumë fëmijëve të jetimores, veçanërisht në periudhën e festave të fundvitit; ata kishin nevojë dhe meritonin vëmendje dhe mbështetje të plotë. Me këtë mendim, 90 kolegë të bankës iu bashkuan kësaj nisme të organizuar në kohë rekord gjatë ditëve të fundit të dhjetorit 2012. Fondet e mbledhura u shpenzuan për të mbuluar nevojat më të domosdoshme të fëmijëve, në bazë të kërkesave të bëra nga drejtuesit e këtyre institucioneve. Ky ishte një shembull i përsosur se sa efektive dhe e thjeshtë është të angazhohemi për të bërë të mundur një jetë më të mirë, në komunitetin ku jetojmë e punojmë.



**Festa e Karnavaleve për Fëmijë**



Një nismë e suksesshme, e organizuar për të dytin vit radhazi, mblodhi 200 punonjës dhe 120 fëmijë të stafit në një atmosfere unike, veshur me kostumet e personazheve të tyre të preferuar në datën 2 mars 2013. Animatorët profesionistë, si: klouni, magjistari, Princesha dhe Spiderman organizuan lojëra e argëtime të ndryshme për fëmijët: pikturim fytyre, kërcime, karaoke, paradë maskash. Në fund, për secilin u krijuan tullumbace shumëngjyrëshe me forma të ndryshme. Qëllimi i eventit ishte të theksonte mbështetjen e bankës për përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve e familjeve të punonjësve të saj, duke kuptuar rëndësinë e balancës mes punës e jetës private, duke i vlerësuar edhe më shumë sakrificat e prindërve në oraret e zgjatura të

punës, duke besuar plotësisht në trekëndëshin: fëmijë të lumtur, prindër të motivuar, biznes i suksesshëm.

## CREDINS BANK

**Credins Bank në bashkëpunim me IFC-në dhe Qeverinë kanadeze, mbështet projektet miqësore ndaj mjedisit në Shqipëri**

Credins Bank, në kuadër të politikave të përgjegjshërisë sociale, ka mbështetur gjithmonë projektet e energjisë së rinovueshme dhe të eficiencës së energjisë, duke nxitur përdorimin efektiv të burimeve dhe uljen e emetimeve të gazit serë. IFC-ja, me mbështetjen e Qeverisë së Kanadasë, mbështeti Credins Bank për zgjerimin e financimeve për projektet e energjisë së rinovueshme, duke ofruar një financim prej 10 milionë Euro për Credins Bank, përfshirë edhe 1 milion Euro nga Programi i IFC-së, Kanada, për nxitjen e investimeve nga Credins Bank në këtë fushë.

**Trajnim i stafit të Credins Bank nga IFC-ja, për financimin e projekteve të energjive të rinovueshme**

Në muajin shkurt, stafi i Credins Bank u trajnuar nga IFC për financimin e projekteve të energjive të rinovueshme. Ky trajnim zgjati tre ditë dhe ishte i pari në një seri trajnimesh të specializuara në mënyrë individuale për bankat lokale në Ballkanin Perëndimor. Forcimi i kapaciteteve të stafit të bankës, veçanërisht në fushën e financimit të projekteve, do të rrisë shanset për të ndërtuar një treg të qëndrueshëm të projekteve të energjive të rinovueshme me fokus në hidrocentralet e vogla



## ■ NBG BANK ALBANIA

NBG Bank Albania ka organizuar disa aktivitete në kuadër të politikave të përgjegjësive sociale në qytetet e Pogradecit dhe Korçës:

**Sponsorizim i futbollistëve të rinj të Klubit "Skënderbeu"** - NBG Bank Albania pajisi ekipin e të rinjve të "Skënderbeut" me uniformat zyrtare të lojës dhe prezantimit. Një ceremoni u zhvillua për këtë rast në fushën sportive të klubit, ku të pranishmit u përshëndetën nga drejtori i Përgjithshëm i NBG Bank Albania, Dr. Ioannis Kougionas, sekretari i Klubit Sportiv "Skenderbeu", z. Gjergji Raidhi dhe trajneri i Ekipit, z. Jani Kaçi.

**Simpoziumi "Ekonomia dhe Bankat"** - Banka organizoi në mjediset e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, simpoziumin me temë: "Ekonomia dhe Bankat". Drejtori i Përgjithshëm i NBG Bank në Shqipëri, Dr. Ioannis Kougionas, dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Sulo Hadëri, prezantuan para audiencës temat mbi ekonominë dhe rolin e sistemit bankar.

**Festimi i 15 vjet prani në qytetin e Korçës** - Banka NBG Albania festoi 15-vjetorin e hapjes së degës në qytetin e Korçës me një koktej ku u ftuan partnerë dhe klientë të bankës. Drejtori i Përgjithshëm i Bankës NBG Albania, Dr. Ioannis Kougionas, informoi të pranishmit edhe për përfshirjen brenda NBG Group të bankës kryesore rivale Eurobank dhe filialeve të saj në rajon.

**Shfaqje për fëmijë** - Si pjesë e një serie aktivitete në rajonin juglindor të vendit, Banka NBG Albania organizoi shfaqje të veçanta për fëmijët e shkollave fillore. NBG Bank tregon shumë kujdes për fëmijët, duke ofruar produkte të veçanta për ta. "Mili dhe Miqtë" është një produkt shumë tërheqës i bankës, që ofron norma interesi konkurruese dhe depozitime pa kufizim nga prindërit dhe të afërmit e fëmijës, në emër të të cilit do të hapet llogaria.

**Banka NBG Albania përkrah maturantët e dalluar të Pogradecit** - Banka NBG Albania zhvilloi një aktivitet në shkollën e mesme të Pogradecit, me pjesëmarrjen e maturantëve të dalluar të kësaj shkolle. Drejtuesja e Bankingut Individual në NBG Bank, zj. Aida Apostoli, paraqiti një prezantim të veçantë për bankën dhe rolin e saj. Një nga kontributet e NBG Bank në qytetin e Pogradecit ka qenë edhe blerja e pajisjes *smartboard*, që ka ndihmuar procesin e mësimdhënies.



## ■ RAIFFEISEN BANK

**Raiffeisen Bank dhuron lule për mësuesit në Ditën e 7 Marsit**

Raiffeisen Bank në Shqipëri, më 7 mars me rastin e Ditës së Mësuesit, ndërmori nismën për të nderuar të gjithë mësuesit që janë klientë të Raiffeisen Bank, duke u dhuruar nga një lule secilit prej tyre me mesazhin: "Raiffeisen Bank ju uron: Gëzuar Ditën e Mësuesit!". Kjo nismë u mirëprit nga më shumë se 26.000 mësues, të cilët marrin pagën në Raiffeisen Bank anëmbanë vendit. Raiffeisen Bank sponsorizoi gjithashtu edhe një sërë aktivitete, që u organizuan nga Drejtoritë Arsimore në Fier, Lushnjë, Durrës, Berat etj., ku u nderuan me certifikata mirënjohje mësuesit më të mirë të shkollave në këto qytete.



## ■ SOCIETE GENERALE ALBANIA

**"Dashuria Mund"**

Societe Generale Albania sponsorizoi Fondacionin "Rilindja Shqiptare" për organizimin e "Dashuria Mund". Fondacioni "Rilindja Shqiptare", me ndihmën e Bashkisë së Tiranës organizoi në datat 12-14 shkurt 2013 evente për të rritur ndërgjegjësimin, si nevojë të aktivizimit social dhe për të promovuar përgjegjësinë si qytetar aktiv, veçanërisht midis të rinjve në Shqipëri. Në datën 14 shkurt u organizua një koncert në pedonalen e qytetit, i cili u marketua përmes mediave sociale: një faqe në rrjetin social Facebook, shpërndarja e informacionit nga mediat lokale, si dhe shpërndarja e fletëpalosjeve në Tiranë.



## UNION BANK

### “Një karafil për klientët në 7-8 Mars!”

Me rastin e 7-8 Marsit, Union Bank organizoi në gjithë degët aktivitete lokale me klientët e saj. U zhvilluan takime dhe u shpërndanë dhurata simbolike në institucione, në qendrat e punës dhe në degë të Bankës.



## VENETO BANKA

### Veneto Banka në nismën “Për një Tiranë Europiane”

Në kuadrin e aktiviteteve të përgjegjshmërisë sociale, Veneto Banka u bë pjesë e një investimi në hapësirat ndarëse të rrugës “Papa Gjon Pali II”, ku ndodhen godinat e Radio Televizionit Shqiptar dhe Ambasadës Italiane. Është kontributi modest i Veneto Banka dhe dy subjekteve të tjera italiane prezent në Shqipëri, të cilat i dhanë jetë një projektit “Për një Tiranë Europiane”, i cili është prezantuar nga Bashkia e Tiranës para disa kohësh.

### Veneto Banka dhe të rinjtë e Kavajës

Veneto Banka në Shqipëri, sponsorizoi me materiale sportive ekipin “Besa” në Kavajë. Aktualisht, ekipi i Besës së Kavajës renditet në vendin e parë të kampionatit shqiptar U-19. Uniformat e reja me logon Veneto Banka, e njohur tashmë në ambientet sportive kryesisht në Itali, si sponsor zyrtar i ekipit të Juventus-it, është një risi shumë e bukur për t’u parë në çdo stadium në Shqipëri, ku luajnë dy ekipet U-19 dhe U-17 të Besës së Kavajës.



# Sue Ryder Care Albania

## RYDER ALBANIA

Shërbim mjekësor në familje për pacientë terminalë dhe të moshuar me sëmundje kronike

Shoqata “Ryder Albania” është një shërbim falas i asistencës në shtëpi (mjekësore, psikologjike dhe social-ekonomike) për pacientët terminalë me kancer, të moshuar me sëmundje kronike: HIV/AIDS etj.. Kjo shoqatë u krijua nëntor 1993 me mbështetjen financiare të Fondacionit “Sue Ryder Care” (SRC), Britani e Madhe.

Aktiviteti kryesor i “Ryder Albania” është ofrimi i shërbimit të Kujdesit Paliativ falas në shtëpitë e pacientëve në Tiranë dhe Durrës. Kujdesi Paliativ është një shërbim relativisht i ri në Shqipëri. Të sëmurët terminalë janë një kontingjent pacientësh, të cilët nuk mund t’i trajtojë spitali, pasi ata s’mund të rrinë gjatë të hospitalizuar atje. Por ata nuk mund t’i trajtojë as ndonjë shërbim tjetër, pasi konsiderohen si pacientë që e kanë mbaruar fazën e kurimit. “Ryder Albania”, me një staf të trajnuar brenda dhe jashtë vendit për kujdesin paliativ, është pionieri i kësaj disipline të re mjekësore në vendin tonë. Pacientët referohen nga strukturat publike të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, spitali onkologjik, ose referime personale. Punonjësi social bashkëvepron me ekipin mjekësor për mbarëvajtjen e shërbimit të kujdesit paliativ dhe ndihmon ndërveprimin me familjarët e pacientit.

Që nga krijimi i Shoqatës “Ryder Albania” deri në dhjetor 2012, është ofruar asistencë falas për më shumë se 6,000 pacientë në Tiranë dhe Durrës. Rreth 69.5% e pacientëve të “Ryder Albania” i përkasin “moshës së tretë”. Për momentin, ofrohet asistencë për 45 pacientë në ditë në Tiranë dhe 37 pacientë në ditë në Durrës.

Çdo individ ose institucion mund t’i bashkohet nismës së shoqatës “Ryder Albania” nëpërmjet projektpropozimeve, eventeve dhe donacioneve në natyrë (medikamente ose materiale mjekësore).

Për më shumë informacion kontaktoni në:

**Adresa:**  
Tiranë, Rr. Ali Pash Gucia, Nd.9, H.7,  
Tel/Fax: 2452309  
Durrës, Rr. A. Goga, L.6,  
Tel: 5230609  
**E-mail:** ryderalb@icc-al.org



Gjatë ngjitjes në Korab

**Xhevahire HOXHA**

Supervizore në Sektorin e Planifikimit dhe Vlerësimit të Rrjetit Alpha Bank Albania.

Megjithëse e konsideron një kënaqësi më vete të punuarit me shifra dhe krijimin e raporteve të shumta, fundjavat i kalon mes natyrës, në vende mahnitëse, që pakkush i ka vizituar. Ngjitja në mal është një aktivitet jo i kushtueshëm por i mrekullueshëm; i lehtë për ta filluar dhe për ta vazhduar, për shkak të natyrës së tij të larmishme e të përshtatshme. Në fillimet e këtij pasioni, familja dhe shumë nga miqtë e saj i bënin të njëjtën pyetje: Pse e dashuron kaq shumë ngjitjen në

“Mali do të më tregojë se kur do të plakem”

Paulo Coelho

mal? Shumë shpejt askush nuk e bënte me këtë pyetje, pasi kuptuan që ngjitja në mal është jetë për të; diçka që nuk e lodh kurrë, përkundrazi i jep asaj një energji të pafund. “Është një aventurë!” – thotë ajo. “Thjesht kurioziteti se çfarë do të jetë pas asaj kodre, ose atij mali të jep fuqinë të vazhdosësh të ecësh me orë të tëra, edhe pse në kurriz ke një çantë të rëndë, në të nxehtë, shi apo borë. Bukuria e ngjitjes në mal është edhe të flesh nën qiellin e hapur, të bisedosh me miqtë rreth një zjarri të madh, të zgjohesh nga puhiza e lehtë e mëngjesit apo zhurma magjepsëse e një lumi apo përroi.”

“Imagjinoni pas 8 orë ngjitjeje më në fund të jesh në majë të Malit Korab, ku vetëm pamjet e pabesueshme të bëjnë të harrosh lodhjen dhe ti fillon mendon sa e fortë je dhe se nuk ke kufij; je e lirë dhe ndihesh krenare që ia arrite... Kjo të motivon dhe të jep energjinë e duhur që të jetosh jetën me të njëjtin pasion çdo ditë, të bën një njeri më të mirë, një profesionist më të mirë.”

- Lartësitë e arritura nga Xhevahire Hoxha:
- Mali i Korabit: 2764 m
- CRETA di Timau: 2218 m (Itali)
- Kleiner Pal: 1866 m (Austri)
- Rauchkofel: 2460 m (Austri – Alpet Karnike )
- Hohe Warte - 2780 m, mali më i lartë i Alpeve Karnike
- Wolayer – 1900 m Liqen në Alpet Karnike

**Flamuri i Bankës Raiffeisen në majë të Himalajeve**

**Gerti PISHTARI**

Menaxher i Produkteve/ Divizioni i Korporatave Raiffeisen Bank

Everesti është maja më e lartë e botës, me një lartësi prej 8.848 metra nga niveli i detit, e duke qenë dhe çatia e botës e bën atë një objektiv i madh, mbase më madhorin, për çdo alpinist. Fizikisht, ajo ka qenë ngjitja më e vështirë që kam bërë deri më tani. E gjithë ekspedita zgjati rreth dy muaj të plotë, nga prilli deri në fund të muajit maj (2012). Grupi ynë filloi të mendojë rreth Everestit që 3 vjet më parë, e që atëherë, unë kam kaluar shumicën e kohës së lirë me trajnime dhe ngjitje. Në fakt, ne jemi shqiptarët e parë që hipëm në majën e Everestit. Ekziston një traditë që, çdo alpinist që ngjit një majë të tillë kaq të lartë, që të marrë me vete flamurin kombëtar. Sigurisht dhe unë e kisha atë, por ai nuk ishte i vetmi; me të kisha dhe flamurin e Raiffeisen Bank. Raiffeisen Bank - Shqipëri ishte sponsori kryesor i aktivitetit dhe për mua, si një menaxher i produkteve bankare elektronike dhe të raportimit, ajo ishte një detyrë, që e përmbusha me kënaqësi, duke rrezikuar disa sekonda më shumë në majë, për të bërë një foto tjetër, me flamurin e Raiffeisen-it. Flamurin nuk e lamë atje, në fakt e kthyem si suvenir në bankë.

Për ngjitje zgjodhëm rrugën e veriut, që është nga Tibeti, Kinë, si rrugë më pak e shkelur, por dhe më shumë teknike dhe më e rrezikshme. Ngjitja në lartësi të mëdha është e vështirë, sa më lart ngjitesh, aq më i rrallë është ajri. Në lartësi të tilla, çdo hap përbën një sfidë më vete. Sa për pjesën më të vështirë në ngjitje të Everestit, mund të them se

vetëm shtatëdhjetë metra poshtë majës, shkëputet një copë shkëmb dhe më godet në gju. Ishte një përpjekje e madhe për të mbledhur të gjitha fuqitë dhe gjithë motivimin, për të arritur në majë e për t’u kthyer përsëri, pavarësisht nga dhimbja.

Sa për të ardhmen, aktualisht jam i përfshirë në projektin “Shtatë majat”, pra shtatë majat më të larta në të shtatë kontinentet. Tashmë jam ngjitur në tre prej tyre, Everest, Elbrus, që është maja më e lartë e Europës dhe Kilimanxharo, maja më e lartë e Afrikës. Ngjitja tjetër e radhës do të jetë ndoshta Akonkagua, maja më e lartë e Amerikës së Jugut.

Këshilla më e mirë për këdo që do të donte për ngjitje në Everest është: “Besoni në të dhe gjithçka është e mundur!” Sigurisht, të jesh i fortë mendërisht dhe të stërvitesh fort është thelbësore. Everesti është një mal që do të rrisë energjitë tuaja!



Foto nga maja e Himalajeve



## LAJME NDËRBALLKANIKE

## BOSNJE - HERCEGOVINË


**Takim i zv/ministrisë të Financave me Drejtorin e Raiffeisen Bank**

*Balkans.com/sarajevotimes.com - 28.01.2013*

Zv/ministria e Financave dhe Thesarit, znj. Edita Dapo, u takua me drejtorin e Raiffeisen Bank në Bosnjë - Hercegovinë, z. Michael Muller. Në takim u diskutua mbi sfidat që priten në fushën e sistemit financiar e atij bankar gjatë vitit 2013. Zj. Dapo deklaroi se janë marrë masa me qëllim përmirësimin e vlerësimit të besueshmërisë së Bosnjë-Hercegovinës, i cili pësoi rënie vitin e fundit për shkak të vonesës në pagimin e borxhit të jashtëm. Në vijim, zv/ministria Dapo falenderoi ekipin menaxherial dhe punonjësit e Raiffeisen Bank për bashkëpunimin e sinqertë që kanë pasur të dy institucionet, në plotësimin kërkesat dhe nevojat specifike të Ministrisë.

**Rritet me 4.27 për qind huaja në vitin 2012**

*Balkans.com/sarajevotimes.com - 13.02.2013*

Sipas Bankës Qendrore të Bosnjë-Hercegovinës, në vitin 2012 rritja e huas ka qenë në normën 4.27 për qind. Megjithatë, kjo rritje nuk është e mjaftueshme për rimëkëmbjen e sektorit dhe pritet që huadhënia nga ana e bankave për këtë vit të jetë më e lartë. Në fund të vitit 2012 totali i huave të sistemit bankar arriti në 15.73 miliardë KM.

## BULLGARIA


**Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, i jep dritë jeshile bashkimit të United Bulgarian Bank me Post Bank**

*Balkans.com Business News Correspondent - 29.01.2013*

Komisioni Bullgar për Mbrojtjen e Konkurrencës dha lejen për blerjen e Postbank nga United Bulgarian Bank (UBB). Vendimi vjen si pasojë e bashkimit të dy pronarëve të dy bankave - National Bank of Greece (NBG) dhe Eurobank. Leja është lëshuar ndaj NBG, por në Bullgari, sikurse dhe në Rumani, Serbi e Qipro, bashkimi do të bëhet ndërmjet dy filialeve UBB (NBG) dhe Postbank (Eurobank). Pas shkrijes, ajo do të jetë banka e dytë më e madhe në Bullgari sipas aktiveve, me 15.3 % të pjesës së tregut.


**First Investment Bank jep ofertën e vetme për të blerë huadhënësin vendor MKB**

*Balkans.com Business News Correspondent - 20.03.2013*

Oferta e vetme për blerjen e huadhënësit vendor MKB Unionbank u paraqit nga First Investment Bank (FIBank) në Bullgari, raporton gazeta bullgare "Kapital". Sipas raportit, FIBank ofroi rreth 100 milion leva, por marrëveshja do të përfshijë dhe një injektim në "cash" prej rreth 350 milion leva, për të zëvendësuar likuiditetet afatshkurtra të injektuara nga aksionarët aktualë. MKB Unionbank zotërohet nga MKB Bank e Hungarisë, që është filial i Bayerische Landesbank (BayernLB) gjermane. BayernLB duhet të shesë shumicën e filialeve të saj të huaja, si pjesë e planit të ristrukturimit, miratuar nga Komisioni Europian në vitin e kaluar.

## KOSOVA


**Guvernatori Gërguri priti misionin faktmbledhës të BERZH-it në Kosovë**

*BQK- 14.01.2013*

Guvernatori z. Gani Gërguri priti një delegacion të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), të kryesuar nga z. Jean-Marc Peterschmitt, drejtor Menaxhues për Europën Qendrore dhe Juglindore. Guvernatori ftoi BERZH-in për një përfshirje më të madhe në ekonominë e Kosovës, me theks të veçantë në ofrimin e mundësive për qasje më të madhe në financime për sektorët më me pak akses të ekonomisë së vendit.

## Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë

BQK-20.02.2013

Në vijim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti me institucionet simotra, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë. Marrëveshja e nënshkruar parasheh thellimin e bashkëpunimit në zhvillimin profesional të punonjësve të të dyja institucioneve me fokus të veçantë në fushën e analizave dhe modelimit makroekonomik, integrimin evropian, planifikimit strategjik, stabilitetit financiar, sistemit të pagesave dhe edukimin financiar.

## KROACIA



Zagreb

### Banka Europiane e Investimeve jep 250 milionë euro për financimin e projekteve të vogla në Kroaci

tportal.hr - 28.01.2013

Përfaqësues të Bankës kroate për Zhvillim dhe Rindërtim (HBOR) dhe Bankës Europiane të Investimeve nënshkruan një marrëveshje financimi prej 250 milionë euro. Nga ky financim do të përfitojnë "projektet e vogla" të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, shoqëritë me kapital mesatar dhe bashkitë në Kroaci. Marrëveshja u firmos nga zv/presidenti i Bankës Europiane të Investimeve z. Anton Rop, dhe nga presidenti bordit drejtues, z. Anton Kovacev.

### Kroacia angazhon bankat për emetimin e obligacioneve në USD

BNE - 14.03.2013

Republika e Kroacisë, e vlerësuar me notat Ba1/BB+/BBB-, ka angazhuar Bank of America Merrill Lynch, Deutsche Bank, Goldman Sachs dhe JP Morgan të organizojnë një seri takimesh me investuesit për një obligacion të mundshëm në Dollarë amerikanë, raporton IFR. Ky emetim mund të ndiqet edhe nga një emetim Eurobond-i në USD, sipas i kushteve të tregut.

## GREQIA



Athinë

### Një ndër pesë hua hipotekore kthehet në hua me probleme

Ekathimerini - 29.01.2013

Numri i familjeve të cilat nuk kanë mundësi pagimi të detyrimit shënon rritje, si rrjedhojë e përkeqësimit të kushteve ekonomike dhe rritjes së taksave. Zyrtarë të bankës qendrore vlerësojnë se në fund të vitit 2012, 20 për qind e huamarrësve nuk kishin mundësi pagese të huave për

shtëpi, detyrim i cili arrin në 15 milionë euro. Gjithashtu, 37 për qind e huave konsumatore klasifikohen si hua me probleme.

### Rriten depozitat dhe tërheqjet në janar të 2013

Ekathimerini - 08.02.2013

Fluksi rritës i depozitave në bankat greke vijoi dhe në muajin janar të 2013-ës, por ai u shoqërua dhe me tërheqje për të kryer pagesat e taksave, sipas zyrtarëve të Bankës Qendrore. Si rrjedhojë, teprica e depozitave mbeti në vlerën 161.45 miliardë Euro, i njëjti nivel me muajin dhjetor 2012, duke u ndjekur nga një fluks neto prej 5.5 miliardë Euro, në muajin e fundit të vitit 2012. Duke pasur parasysh shkurtime të reja në paga dhe pensione, si dhe rritje në detyrimet tatimore, familjarët detyrohen të përdorin depozitat e tyre për emergjencë.

## MALI I ZI



Podgoricë

### Mali i Zi, në diskutime për huan për zhvillim, me vlerë 50 milionë Euro

MNNNews - 25.01.2013

Ministria e Financave me përfaqësuesit e Bankës Botërore diskutuan përgatitjet për një hua për zhvillim, me vlerë rreth 50 milionë Euro. Bisedimet e ministrit të Financave, z. Radoje Zugic, me delegacionin nga Banka Botërore, kryesuar nga z. Abebe Adunga u përqendruan në përgatitjet për huan për zhvillim.

### Bankat e Malit të Zi propozojnë planin e rristurimit të huave me probleme

MNNNews - 06.02.2013

Një projekt pilot për rristurimin e huave me probleme u prezantua nga tetë banka të Malit të Zi. Ky projekt pritet t'i japë zgjidhje problemit, nëpërmjet ligjeve ose amendamenteve të reja. Banka Botërore dhe Banka Qendrore e Malit të Zi organizuan një workshop, për të ngritur problemin e huave me probleme në një mënyrë sa më efektive. Tetë bankat prezantuan shembuj praktikë, lidhur me huat me probleme.

## MAQEDONIA



Shkup

### Maqedonia paraqet huat e reja të subvencionuara për strehim

MIA - 28.01.2013

Ministria e Financave paraqiti lejet për përfituesit e huas së subvencionuar për strehim, pjesë e projektit "Bli një

shtëpi, bli një apartament". Gjatë një viti nga zbatimi i projektit, rreth 110 qytetarë kanë përfituar hua për strehim dhe 640.000 Euro janë subvencionuar nga qeveria.

### Rritje e depozitave në muajin dhjetor 2012

MIA - 14.02.2013

Të dhënat e sistemit bankar për muajin dhjetor kanë treguar rritje në nivelin e depozitave dhe një rritje të moderuar në nivelin e huadhënies. Likuiditeti i sektorit bankar është vazhdimisht në nivel të lartë, e njëkohësisht sipas të dhënave paraprake, është rritur eficientia e sistemit bankar dhe ka një reduktim modest në nivelin e huave me probleme.

## RUMANIA



### Guvernatori i Bankës Qendrore kërkon nga bankat prioritet në huan për biznesin

Ovidiu Posirca - Business Review - 12.02.2013

Sipas guvernatorit të Bankës Qendrore të Rumanisë, z. Mugur Isarescu, disa banka nuk kanë ndryshuar politikat e tyre në ndihmë të biznesit dhe kanë vazhduar të kenë në vëmendje të tyre huat konsumatore për strehim, për të cilat është më e lehtë shitja. Banka qendrore ka vendosur të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.25 për qind, si një lëvizje kyçe e projektuar të përforcojë sektorin privat.

### Bankat në Rumani punësuan 61,739 persona gjatë një viti

Balkans.com Business News Correspondent - 26.02.2013

Sipas Bankës Kombëtare të Rumanisë (NBR), Bankat në Rumani kanë punësuar 61.739 persona gjatë vitit të kaluar, ose rreth 4,000 më pak se viti paraardhës. Z. Nicolae Cinteza, drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes në NBR, citoi se një banke në Rumani i është bllokuar dhënia e huave, si pasojë e shkallës së ulët e aftësisë paguese. Ai shtoi se ndërkohë, është ulur prirja rritëse e huave me probleme.

## SERBIA



### Ministri i Ekonomisë z. Dinkic kërkon nga Banka Qendrore uljen e normës së interesit

BNE - 07.03.2013

Ministri i Financave, z. Mladjan Dinkic, deklaroi se planifikon të kërkojë nga Banka Qendrore e vendit uljen e normës bazë të interesit, më qëllim rigjallërimin e ekonomisë,


raporton agjencia e lajmeve Beta. Norma aktuale konsiderohet më e larta në rajon.

### Banka Kombëtare e Serbisë mban normën bazë të interesit në 11.75 për qind.

Balkans.com Business News Correspondent - 13.03.2013

Bordi Drejtues i Bankës Kombëtare të Serbisë në një takim të tij, vendosi të mbajë normën bazë në nivelin 11.75 për qind. Bordi vlerëson se shkalla aktuale e kufizimit monetar, duke mbajtur gjithçka tjetër të pandryshuar, siguron deri në fund të vitit një kthim të inflacionit brenda intervalit të synuar. Bordi Ekzekutiv vlerësoi se rënia nga viti në vit e inflacionit, do të mbështetet nga zbatimi i vazhdueshëm i programit fiskal të konsolidimit, nga arritja e një marrëveshje paraprake me FMN-në, nga stabilizimi i prituri i çmimeve bujqësore, e gjithashtu dhe nga zbatimi i rregullimeve të njoftuara në çmimet e administruara.

## TURQIA



### Moody's: Sistemi bankar turk mbetet i qendrueshëm

Moody's - 24.01.2013

Sipas Moody's Investors Service sistemi bankar turk mbetet i qëndrueshëm. Në një vlerësim të ri të sistemit bankar, pikat kryesore ku mbështetet ky vlerësim janë: (1) pikëpamja e agjencisë së vlerësimit, sipas së cilës rritja e moderuar ekonomike dhe përmirësimi i fuqisë financiare sovrane do të krijojë kushte operative mbështetëse për bankat, pavarësisht uljes së rreziqeve nga kriza e Eurozonës, tregjet e paqëndrueshme; dhe (2) burimet e mjaftueshme të bankave për të absorbuar një rritje të pritshme të huave me probleme. Bankat kanë burime të mjaftueshme të përballen edhe me humje më të mëdha nga pritshmëria, duke patur një raport bazë (Tier 1 ratio ,Basel II) 14.5% dhe raport të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas agjencisë Moody 12 % , në shtator 2012.

### Sektori i bankingut islamik turk do të trefishohet brenda 10 vjetësh

Balkans.com Business News Correspondent - 22.03.2013

Sektori i bankingut islamik turk do të trefishohet brenda 10 vjetëve, ndërsa vendi do të ketë edhe më shumë potencial nëse do të plotësojë kërkesën e huaj, duke ofruar më shumë nga shumëllojshmëria e instrumenteve financiarë islamikë, sipas raportit të Ernst & Young. Raporti thotë se bankat pjesëmarrëse turke janë zgjeruar çdo vit mesatarisht me 198 për qind dhe vëllimi tregtar arriti në 1.3 miliardë dollarë në vitin 2011.

•Kredi •Depozita •Biznes  
•Transferta



**KEMI FITUAR QETESINE ME**

## MONITORIMI NË KOHË REALE KUNDËR MASHTRIMEVE, SI MASË REVOLUCIONARIZUESE PËR ZBULIMIN E MASHTRIMEVE



**nga Francisco JARAMILLO<sup>1</sup>**  
Drejtor i Përgjithshëm  
Europa Juglindore – Visa

Siguria ka qenë gjithmonë guri i themelit të strategjisë së shoqërisë VISA, ndaj futja së fundi e teknologjive të përparuara të parandalimit të mashtrimit vjen natyrshëm dhe jo papritmas. Zgjidhjet e reja, më të “zgjara” dhe “autodidakt”: “Autorizimi i Përparuar, Visa” (Visa Advanced Authorization, VAA) dhe “Menaxheri i Rrezikut, Visa” (Visa Risk Manager, VRM), u ofrojnë institucioneve financiare nivele të panjohura më parë, lidhur me mbrojtjen në kohë reale, si dhe përgjigje nëpërmjet të gjithë rrjetit global të VISA-s. Ato janë të projektuara në mënyrë të tillë që të rrisin sigurinë për bankat në Shqipëri, si dhe të ofrojnë mbrojtje më të madhe për mbajtësit e kartave VISA.

Nuk përbën sekret fakti që zgjerimi në të gjithë botën e pagesave jo në para fizike, shoqërohet me zhvillimin e teknikave të reja e më të sofistikuar të mashtrimit. VISA i kundërpërgjigjet atyre me futjen e teknologjisë së re, për t’i zbuluar këto kërcënime të reja si dhe për të ndihmuar në shuarjen e tyre që pa u zhvilluar mirë. Zgjidhjet

VAA-ja dhe VRM-ja është një zgjidhje e kombinuar për parandalimin në mënyrë gjithëpërfshirëse të mashtrimeve, duke u mundësuar bankave pjesëmarrëse në emetimin e kartave ta identifikojnë më mirë e ta ndalojnë mashtrimin, para se ai të ndodhë.

e reja VAA dhe VRM kanë aftësinë të identifikojnë dhe përballen me sulmet e bashkërenduara ndaj shumë llogarive në kohë reale. Duke u mbështetur në një nga rrjetet më të përparuara elektronike të pagesave, bankat shqiptare do të kenë qasje tani në një instrument më “të zgjuar” të menaxhimit të rrezikut, për çdo transaksion të përpunuar. VAA është teknologjia që “vlerëson” (u vendos një notë) transaksioneve të kryera me karta, ndaj mundësive për mashtrim, duke u bazuar në aktivitetin dhe prirjet globale, përgjatë gjithë rrjetit VISA në botë. Numri tejet i madh i transaksioneve që kalojnë nëpërmjet rrjetit i jep mundësi emetuesve të kartave që nëpërmjet zgjidhjes VAA, të zotërojnë një notë rreziku me saktësi të lartë dhe në kohë reale.

VRM-ja u mundëson bankave që ta shndërrojnë depërtimin unik global të VAA-së në veprime të menjëhershme, duke dhënë përgjigje specifike, lidhur me anulimin e transaksioneve, ose cilësimin e tyre si të dyshimta, në kohë reale. Duke pasur parasysh se ekzistojnë kritere të ndryshme për institucione të ndryshme, VRM-ja u lejon bankave emetuese t’i formulojnë përgjigjet në përputhje me profilin e tyre të rrezikut dhe kriteret të rrezikut. Aktualisht, zbulimi i mashtrimit bazohet kryesisht në pro-

cesin sekuenial: identifikim, sinjalizim dhe përgjigje. Megjithatë, skemat globale të mashtrimit janë të vështira të identifikohen, në qoftë se ekspozimi ndaj atyre është i kufizuar, koha e përgjigjes mund të jetë tepër e ngadalshme për të ndaluar mashtrimin. Sapo ky i fundit sinjalizohet, si dhe kur sinjalizimi për mashtrim, pasi ai ndodh, shpesh merr kundërpërgjigje

Sistemi do të jetë në gjendje të shënjojë në mënyrë më të imtësishme lloje të ndryshme mashtrimesh - madje që në momentin e lindjes së tyre – duke u mundësuar emetuesve të kartave t’i veçojnë në mënyrë më të saktë transaksionet mashtruese nga ato të ligjshme.

<sup>1</sup> z. Francisco Jaramillo, Drejtor i Përgjithshëm- Europa Juglindore, Visa

Ai ka qenë i angazhuar në biznesin e kartave dhe industrinë e pagesave elektronike në Europë, gjatë 12 viteve të fundit: si drejtor i Përgjithshëm i Kartave Tregtare për Spanjën dhe Portugalinë, në shoqërinë “American Express”, si drejtor Rajonal për Zhvillimin Strategjik të Biznesit të Kartave Tregtare për Europën Qendrore (Poloninë, Hungarinë, Republikën Çeke dhe Sllovakinë) në “American Express”, Zëvendës-presidenti Planifikimit Strategjikut të Marketingut në “VISA Europe”, si dhe tani drejtori Përgjithshëm për Europën Juglindore (Shqipërinë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Maline Zidhe Serbinë), në VISA Inc.

që vijnë shumë vonë. Sistemi i ri i VISA-s i shmang këto rreziqe dhe ofron një sistem proaktiv, i aftë të sigurojë një lajmërim (sinjalizim) të hershëm dhe veprim të menjëhershëm – duke zvogëluar ndjeshëm numrin e përpjekjeve mashtruese, si dhe numrin e përpjekjeve të finalizuara të mashtrimeve. Për më tepër, sistemi i ri është “autodidakt”, i aftë të mbajë mend dhe rikujtojë të gjitha rastet dhe prirjet e reja.

Bankat shqiptare po e shfrytëzojnë një mundësi të tillë, për të qenë një hap para nga mashtruesit.

### **Cfarë është Autorizimi i Përparuar Visa (Visa Advanced Authorization, VAA)?**

Ajo është një teknologji e sigurisë, që analizon rezultatet dhe vlerëson me një notë të vaktuar çdo transaksion të kryer me kartën VISA, lidhur me mundësinë për mashtrim, bazuar në një qasje globale të mashtrimit, përgjatë gjithë rrjetit të VISA-s. Nota e vlerësimit për rrezikun gjenerohet nga një rishikim në kohë reale që i bëhet aspekteve të shumta të çdo transaksioni, përfshirë këtu dhe aktivitetin e mëparshëm të klientit, si dhe ngjashmërinë me transaksione të tjera të dyshimta, në të gjithë rrjetin e kartave VISA. Emetuesi i kartës mund ta përdorë këtë informacion me vlerë, për të vendosur në kohë

reale lidhur me autorizimin ose jo të transaksionit.

Sistemi do të jetë në gjendje të shënjojë në mënyrë më të imtësishe lloje të ndryshme mashtrimesh – madje që në momentin e lindjes së tyre – duke u mundësuar emetuesve të kartave t’i vëçojnë në mënyrë më të saktë transaksionet mashtruese nga ato të ligjshme. Nga ana e tjetër, Menaxheri i Rrezikut, Visa (Visa Risk Manager, VRM), i ndihmon institucionet financiare të krijojnë, testojë dhe ekzekutojnë lehtësisht rregullat e autorizimit të kartave, duke ndihmuar kështu emetuesit të anulojnë transaksionet mashtruese. Rregullat e reja mund të zbatohen brenda disa minutave, duke iu përgjigjur prirjeve të mashtrimit në proces. Menaxheri i Rrezikut, Visa ofron një sërë kompetencash/afhtësish, përfshirë këtu “Vendimmarrjen në Kohë Reale, Visa” (Visa Decisioning Real Time) dhe “Menaxherin e Rasteve, Visa” (Visa Case Manager). “Vendimmarrja në Kohë Reale, Visa” i jep institucioneve financiare aftësinë që të lejojnë VISA-n të veprojë në emër të tyre, për të anuluar ose të dërgojë për veprim të menjëhershëm te emetuesi, transaksionet me rrezik të lartë mashtrimi, duke përdorur rregullat e paracaktuara, të krijuara nga emetuesi i kartës. Ky shërbim në kohë reale i trajton mashtrimet e mundsh-

me, ndërkohë që ato rrjedhin përgjatë rrjetit të VISA-s, kështu që nuk ka nevojë për të arritur deri te emetuesi.

Pasi transaksionet kalojnë përmes procesit normal të autorizimit nga emetuesi, aplikacioni përmes internetit “Menaxheri i Rasteve, Visa” (Visa Case Manager) i jep mundësi emetuesit të shikojë, priorizojë dhe menaxhojë transaksionet që kërkojnë hetime të mëtejshme. VAA-ja dhe VRM-ja është një zgjidhje e kombinuar për parandalimin në mënyrë gjithëpërfshirëse të mashtrimeve, duke u mundësuar bankave pjesëmarrëse në emetimin e kartave ta identifikojnë më mirë dhe ta ndalojnë mashtrimin para se ai të ndodhë. VAA mund të analizojë një transaksion për disa milisekonda dhe t’u sigurojë bankave emetuese të kartave një notë vlerësimi të rrezikut, me saktësi tejet të lartë. Rrjedhimisht, VRM-ja u lejon këtyre bankave të përmirësojnë vendimmarrjen, në mënyrë që ato mund të kthejnë perceptimin në veprim. Kjo shpejtësi dhe qartësi e jashtëzakonshme i lejon ato të parandalojnë mashtrimin që në gjenezë.

Për më shumë informacion rreth VAA-së dhe VRM-së vizitoni: <http://www.advancedauthorization.com/>



NBG Bank

Jorgo DHROSO,  
Menaxher IT, NBG Bank:

Për bankën tonë, siguria dhe besueshmëria e transaksioneve të kryera nga klientët nëpërmjet kartave të debitit/kreditit kanë një rëndësi të veçantë. Më parë ne përdornim raporte standarde për monitorimin e këtij aktiviteti, por duke parë prirjen në rritje të mashtrimit me karta në vend dhe me gjerë, ishim të ndërgjegjshëm se problemi kishte nevojë për një trajtim me cilësor.

VAA zgjoi interesin tonë për shkak të disa përfitimeve thelbësore që ofronte. Fillimisht, sistemi të ofrohet pa kosto për një periudhë të caktuar, në mënyrë që të vendosësh qetësisht nëse ai arrin t’i përbushë nevojat që ke ose jo. Investimi fillestar si në pajisje apo në programe është zero – thjesht regjistrohesh dhe fillon të përdorësh menjëherë ndërfaqen e thjeshtë mbi web. Veçori unike e sistemit është nota (score) me të cilin vlerësohet çdo transaksion. Kjo e fundit gjenerohet bazuar mbi përpunimin që Visa i bën të dhënave në mbarë botën – për rrjedhojë asnjë sistem tjetër nuk e ka aftësinë për të bërë një vlerësim të tillë. Së fundmi, kostot e përdorimit janë vërtet të ulëta, në krahasim me atë që të ofrohet.

Në këndvështrimin tim, VAA është mjaft i vlefshëm për të gjitha ato banka që nuk përdorin një sistem kundra mashtrimeve, sikundër mund të sjellë një vlerë e shtuar edhe në ato banka që aktualisht e përdorin një sistem të tillë.



Erion MAXHARI,  
Drejtor i Departamentit të Kartave, Fibank:

Fibank është një nga tre bankat që po e testojnë VRM-në në Shqipëri. Kur nisëm fillimisht të përdornim VRM-në, mund të evidentonim mashtrime me karta në një kohë shumë të shkurtër, gjatë kohës kur transaksionet me nota filtroheshin nga rregullat tona. Si sistemi ashtu edhe përdoruesi përmirësohen dita-ditës, prandaj mund të themi që është një proces mësimi i dyanshëm. Me fleksibilitetin e ofruar nga VRM-në tashmë kemi mundësi të ndalojmë veprime me rrezik menjëherë, e në disa raste, kur kemi një konfirmim nga klienti që veprimi është në rregull, mund ta lejojmë atë kartë në disa minuta të kryejë një transaksion të rregullt. Besojmë që klientët e Fibank përmes përparësive të kartave tona, do të jenë më të mbrojtur, pasi ne po u sigurojmë mënyrën më të shpejtë për të kapur mashtrimet me karta. Tashmë ata duhet vetëm të mendojnë për t’u pajisur me kartat Fibank, t’i përdorin sa më shumë ato dhe të lehtësojnë jetën e tyre nëpërmjet dobive që i sjellin kartat.

## ANGAZHIMET PËR HUAT

Pjesa dërrmuese e huave për biznes akordohen në formën e angazhimeve për huat, pasi ekzistojnë arsye të forta për t'i përdorur ato, si nga bankat ashtu dhe nga klientët e tyre (të biznesit); ato janë një pjesë e pandarë e marrëdhënieve të bankës me klientët e saj

*përgatitur nga Junida TAF AJ  
AAB*

Së fundi po fillojnë të studiohen faktorët përcaktues të kontratave të angazhimeve për huat, ose të linjave të kredisë. Kontrata të tilla luajnë një rol tejet të rëndësishëm në shpërndarjen (akordimin) e huas bankare. Mbi 70% e huave tregtare dhe industriale në SHBA jepen në formën e kontratave të angazhimeve për huat. Këto kontrata kanë rëndësi si në nivel mikro, në kuadër të marrëdhënieve bankë-klient, ashtu dhe në nivel makro, në drejtim të kanaleve të zbatimit të politikës monetare.

Angazhimi për huan është një premtim për t'i huajtur një klienti të caktuar një sasi të paracaktuar fonde-sh, sipas disa kushteve të paracaktuara. Një premtim i tillë është i vlefshëm për një periudhë paracaktuar kohe (që duhet bërë kujdes të mos ngatërrohet

me afatin e maturimit të huas). Kushtet, zakonisht përcaktojnë se si llogaritet norma e interesit të huas, maturimi i saj dhe se si do të përdoren fondet e huajtura. Përfitimi i bankës nga shitja e angazhimit për huan shprehet në forma të ndryshme, madje të kombinuara në forma të ndryshme. Ai mund të jetë në formën e një komisioni për angazhimin, që shprehet në një përqindje të caktuar ndaj vlerës totale të angazhimit e që paguhet paraprakisht nga huamarrësi, kur negociohet angazhimi për huan. Ai mund të jetë gjithashtu në formën e komisionit të përdorimit, që zbatohet mbi pjesën e papërdorur të huas. Shumë shpesh, komisionet për angazhimin dhe përdorimin përdoren njëkohësisht. Gjithashtu, bankat përdorin shpesh dhe komisionet e shërbimit për shu-

mën e marrë hua, me qëllim mbulimin e kostove të transaksioneve të bankës, si dhe kërkesat për balancat kompensuese, që janë depozita në shumën të caktuar, që huamarrësi duhet t'i mbajë pranë bankës, gjatë gjithë periudhës së marrëdhënies së tyre të angazhimit.

**Përdorimet e angazhimeve për huat**  
Shumica e huave për biznes akordohen sipas kontratave të angazhimeve për huat. Këto përfshijnë huat për ndërtim dhe zhvillim territori, hua për të financuar blerjet me përdorim të levës financiare (LBO) dhe ato për realizimin e bashkimeve, apo shkrirjeve dhe blerjeve (M&A). Angazhimet për huat përfshijnë edhe linjat mbështetëse të kredisë për letrat tregtare (banka

Një marrëveshje tillë sjell përfitime, si për bankën, ashtu dhe për huamarrësin. Huamarrësi është i garantuar për akordimin e një huaje, me një normë të përcaktuar, të cilën mund ta tërheqë kurdo, gjatë periudhës së përcaktuar. Banka arkëton të ardhura nga interesi prej pjesës së linjës së kredisë që tërheq huamarrësi, ndërkohë që arkëton të ardhura jo nga interesat, prej pjesës së papërdorur të angazhimit.





## SHËRBIME BANKARE ME KOMISION 0

- Hapje e llogarisë rrjedhëse
- Derdhje / Tërheqje / Nxjerrje / Kalime llogarie
- Hapje depozite / Këmbime valutore
- Pagesat e faturave mujore
- Tërheqja / Pagesat e kësteve të kredisë
- Karta e debitit - Visa Electron
- Tërheqje ATM (Veneto Banka) / Blerje në POS (Shqipëri)
- Aktivizimi / Pagesat me e-banking (klientë individë)

**Veneto Banka, jeni në rrugën e duhur.**

[www.venetobanka.al](http://www.venetobanka.al)



**VENETO BANKA**  
GRUPPO VENETO BANCA



bie dakord të japë hua për klientin, si një alternativë ndaj emetimit të letrave tregtare) dhe lehtësitë për emetimin e notave<sup>1</sup> (sipas të cilave banka bie dakord të blejë notat afatshkurtra të një huamarrësi, nëse ky i fundit nuk arrin t'i shesë ato në treg.)


### Llojet e angazhimeve për huat

Përveç mënyrave të përdorimit, angazhimet për huat mund të klasifikohen edhe sipas natyrës së sigurimit të normës së interesit që i ofrohet klientit. Angazhimet ndryshojnë në varësi të shkallës së sigurimit që i ofrojnë ato huamarrësit. *Angazhimet me normë fikse për huat* i japin klientit të drejtën për të marrë hua me një normë interesi që njihet paraprakisht dhe kështu ai eliminon pasigurinë për normën e interesit dhe disponueshmërinë e huas. *Angazhimet me normë të ndryshueshme për huat* (ose me formulë fikse), që janë dhe më shumë të përdorshëm, nuk përcaktojnë një normë huamarrje fikse. Përkundrazi, ai e përcakton normën sipas një formule që mbështetet në një normë referencë. Dy formulat më të zakonshme janë: formula shtuese dhe shumëfishuese. Sipas formulës shtuese, norma e huamarrjes është e barabartë me një normë indeksi të caktuar (p.sh.: LIBOR), në momentin e tërheqjes, plus një shtesë fikse. Sipas formulës shumëfishuese, që përdoret rrallë, norma e huamarrjes është e barabartë me normën e një indeksi të caktuar, në momentin e tërheqjes, shumëzuar me një konstante të përcaktuar.

### Arsyet për përdorimin e angazhimeve për huat

Ka disa arsye që shpjegojnë rëndësinë gjithnjë në rritje dhe përdorimin e angazhimeve për huat. Bankat kanë stimujt dhe përfitimet e mëposhtme:

- (A) **Ngarkesat rregullatore:** Deri në momentin kur angazhimi për huan tërhiqet praktikisht, huaja nuk akordohet, që do të thotë se nuk kryhet ende financim. Rrjedhimisht, banka nuk ka nevojë të sigurojë depozita deri në momentin e tërheqjes së fondeve nga klienti, që nënkupton se kërkesat për rezerva të detyrueshme nuk ndikojnë në këtë angazhimin deri në atë moment.
- (B) **Pavarësia vendimmarrëse kontraktuale dhe reputacioni:** Meqenëse pretendimet kontigjencë janë premtime për të ofruar diçka në të ardhmen, por që pashmangshmërisht



përfshijnë dhe “klauzolën MAC<sup>2</sup>”, që i jep bankës pavarësi vendimmarrëse kontraktuale dhe të mos respektojë premtimet e saj, në rrethana “të justifikuar”, emetimi i pretendimeve të tilla përmirëson aftësinë e bankës për të menaxhuar portofolin e saj të kapitalit financiar dhe atij reputacional. Pra, ky vendim mund të shihet si një kompromis optimal midis kapitalit reputacional dhe atij financiar të bankës, e kjo në thelb është një veprim i “lubrifikimit” të kapitalit të saj reputacional, pasi ky nuk është i tregtueshëm, si kapitali i saj financiar.

- (C) **Parashikimi i kërkesës:** Banka, nëpërmjet angazhimeve për huat, mund të marrë informacion të vlefshëm, lidhur me kërkesën për hua në të ardhmen. Kjo pasi klientët do të blejnë (kërkojnë) angazhime për fonde që lidhen me nevojat e pritshme për huamarrje të tyre në të ardhmen.

### Klientët kanë stimujt dhe përfitimet e mëposhtme:

- (A) **Konsideratat për ndarjen e rrezikut:** Në rastin e një angazhimi normë fikse për huat, banka mbart si rrezikun e ndryshimeve në normën e interesit të indeksit, ashtu dhe atë të ndryshimit në shkallën e rrezikut të besueshmërisë së huamarrësit, ndërkohë që në rastin e angazhimit me normë të ndryshueshme për huat banka mban vetëm rrezikun e dytë. Në secilin rast, huamarrësi kundërshtues rreziku transferon (një pjesë të) rrezikut të normës së interesit te banka.
- (B) **Dëmi moral:** Angazhimet për huat shërbejnë si një instrument për bankat për të anashkaluar efektin shtrembërues të normës së interesit të huas, pa u mbështetur në alternativa të tjera më të kushtue-

shme. Kjo mund të arrihet duke ulur normën e interesit për huat në një nivel të mjaftueshëm për të eliminuar (ose në mënyrë të konsiderueshme zvogëlon) rrezikun moral. Pra, huamarrësit mund të kërkojnë angazhime për huat, pasi ata kanë mundësi të marrin hua me kushte më të mira, në përputhje me angazhimet e marra në tregun me shlyerje të menjëhershme.

- (C) **Garanci likuiditeti për kreditorët e tjerë:** Kur një firmë blen një angazhim për huat, furnizuesit e lëndëve të para për firmën e dinë se firma do të kenë qasje në likuiditete, të barabartë me shumën e angazhimit. Kjo mund t'i risigurojë furnizuesit që firma, do të kenë fondet e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të borxhit të saj.
- (D) **Mbrojtja kundrejt racionimit të huas në të ardhmen:** Qasja në huamarrje në të ardhmen, që mund të ketë një huamarrës, cenohet nga tre ngjarje të mundshme: (1) përkeqësimi në gradën e besueshmërisë së klientit, (2) përkeqësimi i disponueshmërisë së huave për të gjithë tregun dhe (3) ndryshimet në factored, që lidhen ngushtësisht me bankën, e që pakëson aftësinë e bankës për të dhënë hua. Angazhimi për huat e mbron blerësin kundrejt ndodhjes së dy mundësive të para.
- (E) **Zvogëlimi i mangësive të tregut:** Kur tregu i kapitaleve është i paplotë (pra, mungojnë mundësitë për ndarjen e rrezikut), angazhimet për huat prodhojnë një sërë përfitimesh për huamarrësit, të cilat nuk mund të arrihen nga kombinime lineare të letrave me vlerë ekzistuese, kështu që disponueshmëria e një angazhimi për huat zvogëlon mangësitë (paplotesinë) e tregut.

<sup>1</sup> NIF - Note Issuance Facilities.

<sup>2</sup> MAC - Ndryshim thelbësor jo i favorshëm (Material Adverse Change). Klauzolë që i lejon bankës të tërhiqet nga angazhimi, nëse gjendja financiare e klientit përkeqësohet “thelbësisht”, gjatë periudhës që nga momenti i emetimit të angazhimit, deri në momentin e ushtrimit të tij nga klienti.

# AKTIVITETET E SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

## AAB - PËR EDUKIMIN FINANCIAR

AAB, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit organizuan aktivitetin me temë “Rëndësia e edukatës financiare”, në kuadër të javës ndërkombëtare të edukimit financiar, 20 shkurt 2013

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave organizuan aktivitetin me temë “Rëndësia e edukatës financiare”. Aktiviteti u organizua në mjediset e Shkollës së Mesme Ekonomike në Tiranë, në kuadër të “Global Money Week”, javës ndërkombëtare kushtuar edukimit të të rinjve dhe njohjes së tyre me konceptet si kursimi, bankingu, produktet bankare dhe mjetet financiare. Nxënësit dhe mësuesit u përshëndetën nga përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Bankave, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit. Ky aktivitet u organizua në vijim të angazhimit për edukimin ekonomik dhe financiar të publikut nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.



## AAB - TRAJNIME PËR BANKIERËT

Trajnim mbi “Menaxhimin e rrezikut të kreditimit”, 20-22 shkurt 2013

AAB, në bashkëpunim me Institutin Financiar Inxhinierik për Bankë dhe Sigurime, organizoi një kurs trajnimi treditor me temë: “Menaxhimi i rrezikut të kreditimit”. Kursi u projektua për të pasqyruar mënyrën e krijimit të një menaxhimi të suksesshëm të kreditimit, duke përdorur mënyrën më të përparuar të identifikimit të rrezikut të kreditimit. Trajnimi u drejtua nga z. Ilir Hoti dhe u ndoq nga përfaqësues të 12 departamenteve të rrezikut të kredisë të 7 bankave anëtare.



Trajnim për “Kujdesin ndaj klientit, shitjet dhe aftësitë negociuese”, 26-27 shkurt 2013

AAB organizoi një kurs dyditor për “Kujdesin ndaj klientit, shitjet dhe aftësitë negociuese”. Kursi u fokusua në praktikat më të mira të kujdesit ndaj klientit, shitjeve dhe aftësive negociuese. Pjesëmarrësit u përfshinë në diskutime, analiza, ushtrime dhe aktivitete të tjera, për të arritur përfitim maksimal. Kursi u drejtua nga z. Paul Gauci dhe u ndoq 14 pjesëmarrës nga 6 banka anëtare.

Trajnim mbi “Praktikat më të mira të drejtimit”, 28 shkurt-01 mars 2013

AAB organizoi një program trajnimi dyditor për menaxherë dhe drejtues grupi. Trajnimi u ndoq nga 14 pjesëmarrës nga 6 banka anëtare dhe u drejtua nga z. Paul Gauci. Objektivi kryesor i këtij kursi ishte përforcimi i drejtimit, komunikimit, motivimi dhe ndërtimi i aftësive për ndërtimin e grupeve, duke mundur efektivitet dhe rezultate. Kursi u mundësua nëpërmjet një qasje interaktive trajnimi, duke përdorur pyetësorë, ushtrime pjesëmarrje, video dhe diskutime në grup.



Trajnim mbi “Menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit”, 6-7 mars 2013

AAB, në bashkëpunim me “Deloitte”, organizuan trajnimin dyditor me temë: “Menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit”. Temat e trajtuara u përqendruan në krijimin e planit dhe dokumentimin, në ndikimin e analizës së biznesit, strategjisë së rikuperimit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të “Menaxhimi të vazhdimësisë së biznesit”. Trajnimi u ndoq nga 9 punonjës të 5 bankave anëtare.



Trajnim mbi “Trajnim për trajnerë”, 26-27 mars 2013

AAB në bashkëpunim me “Partners Albania” organizoi një trajnim me temë: “Trajnim për trajnerë”. Ky trajnim u fokusua në organizimin e një trajnimi efektiv, duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi. Kursi u ndoq nga 6 pjesëmarrës të 4 bankave anëtare dhe u projektua në formën e një trajnimi ndërveprues.

## AAB - AKTIVITETE NË VIJIM

 ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

 **FORUMI I 3-të**  
**KOMBËTAR SHQIPTAR I KARTAVE**

**“DREJT NJË TË ARDHME**  
**DINAMIKE TË BIZNESIT”**

**17 Maj 2013**

Illyria 1, Hotel Sheraton Tirana

    ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

 ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

**FORUMI I 2-të**  
**KOMBËTAR SHQIPTAR PËR**  
**SIGURINË NË BANKA**

31 Maj 2013, Tiranë

Salla Abret,  
Tirana International Hotel

